



Analiza e Politikave

Udhës për n'BE: Mundësitë e zhvillimit me bazë në zonë

8 prill, 2011



Analiza e Politikave

Udhës për n'BE: Mundësitë e zhvillimit me bazë në zonë

8 prill, 2011

Kjo analizë e politikave u hartua me përkrahjen zemërgjerë të projektit të financuar nga BE-ja dhe të menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë



Analiza e politikave dhe përmbajtja janë përgjegjësi ekskluzive e IKS-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shihen si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
I. NË RRUGË DREJT RRITJES EKONOMIKE	7
PENGESAT NË PROCESIN E PRIVATIZIMIT	11
NXITËS I RRITJES? SEKTORI PRIVAT I GJAKOVËS	16
II. DREJT ZHVILLIMIT NJERËZOR	27
TË RINJTË: FORCË SHITYTËSE APO FORCË NË LARGIM E SIPËR?	30
RRUGË E DREJT APO E TËRTHORTË: TË DREJTAT E GRUAS DHE BARAZIA GJINORE	33
TË ANASHKALUAR? ROMËT, ASHKALIJTË DHE EGJIPTASIT NË GJAKOVË	44
III. BRUKSELI APO DËSHTIMI	53

HYRJE

Duke vozitur me makinë nga Prishtina drejt jugpërendimit, shpejt vërejmë se rrugët e ndërtuara rishtazi përreth kryeqytetit të Kosovës përfundojnë pak para kthesës në drejtim të qytetit të Gjakovës.¹ Ndërtimi i rrugëve, njëra prej politikave kryesore të Qeverisë së Kosovës, duket se e ka anashkaluar Komunën e Gjakovës. Rrugët përplot vrima të çojnë drejt 86 fshatrave të kësaj komune ku jetojnë afro 60,000 banorë. Në pranverë dhe vjeshtë, bujqit i punojnë pjesët e vogla të tokës afër shtëpive të tyre. Pasi të ofrojnë kafe turke dhe molla të freskëta e të ëmbla nga vreshtat e tyre, ata tregojnë se jeta e tyre është më e mirë se para 10 vitesh; me anë të ndihmave ndërkombëtare ata kanë rindërtuar shtëpitë e tyre të djegura dhe kanë arritur të mbjellin mjaft produkte ushqimore. Mirëpo, shumë prej atyre akoma nuk mund të mbulojnë shpenzimet e kujdesit shëndetësor, rrymës elektrike, librat shkollor dhe biletat e autobusit për fëmijët e tyre, e kjo në veçanti vlen për gratë që vet i udhëheqin ekonomitë e tyre familjare. Ata ankohen se politikanët nuk i vizitojnë fshatrat e tyre dhe nuk çajnë shumë kokën për vështirësitë me të cilat ballafaqohen ata.

Ne vazhdojmë udhëtimin tonë dhe pak para se të futemi në qytetin e Gjakovës, kalojmë pranë vreshtave të pakultivuara të Rrafshit të Dukagjinit i cili dikur ishte i pjellshëm. Bodrumi i madh dhe i braktisur i verës, *Ereniku*, qëndron pranë rrugës, një përkujtim i përhershëm për procesin e ngecur të privatizimit. Strehë e verës së prodhuar në vitet 1970 dhe 1980, *Ereniku* është njëra prej 39 ndërmarrjeve shoqërore (NSH-të)² që ende presin të privatizohen. Dikur njëra prej qendrave industriale të Kosovës, shumica e NSH-ve të Gjakovës sot nuk funksionojnë dhe kanë ngecur në qarkun e kontesteve pronësore. Si rezultat, në këtë qendër të dikurshme të prodhimtarisë dhe tregtisë, numri i njerëzve që jetojnë nga asistenca sociale sot është shumë më i madh se numri i atyre të regjistruar si të punësuar dhe që paguajnë tatime.

¹ Emërtimi ‘Gjakovë’ përdoret në vend të emërtimit zyrtar Gjakovë/Djakovica sepse i pari përdoret nga shumica dërrmuese e qytetarëve të Gjakovës.

² NSH si term është i kontestueshëm. Drejtorët e dikurshëm dhe aktual të këtyre ish-ndërmarrjeve shoqërore insistojnë që këto ndërmarrje janë privatizuar me ‘ligjet e Markoviçit’ për transformimin e kapitalit (Ali Buza, drejtor i *Elektromotorri*, punëtorja konsultative e IKS me grupet e interesit, Gjakovë, 29 Tetor 2010). Shih kapitullin tjetër për diskutime të më tutjeshme.

Sapo hymë në qendrën urbane të Gjakovës, e cila ka afro 90,000 banorë, ne ndalemi për një makiato.³ Është vështirë të gjesh vend të lirë në kafene në mesin e studentëve të shkollës së mesme të cilët vazhdimisht flasin se çka po i pret pas maturës. Me mundësi të kufizuara për punësim apo arsim të lartë, ndoshta ata do ti ndjekin hapat e parardhësve të tyre të cilët janë larguar në Prishtinë në kërkim të një jete më të mirë.

Gjakova në një shikim

Banorë	Rural #	%	Urban	%
150,000	60,000	40.0% ⁴	90,000	60.0%
Gjinia	Femra		Meshkuj	
	76,500	51.0%	73,500	49.0%
Mosha⁵	Nen 15		15-64	
	47,000	31.2%	77,500	51.4%
Të punësuar⁶	Sektori Publik		Sektori Privat	
8,364	3,730	40.0%	4,634	60%
Të papunë	Shkalla			
18,827 ⁷	42.3% ⁸			
Pranuesit e skemës së Mirëqenies Sociale (të gjithë)	Pranuesit e ndihmës Sociale	Pensionistët	Personat me nevoja të vecanta	Familjet e martirëve / invalidëve të luftës
29,658 ⁹	14,779 ¹⁰	9,893 ¹¹	2,548 ¹²	2,438 ¹³

³ Bazuar në vlerësimet për numrin e popullatës, shih OSBE, profili i komunës së Gjakovës, 2005.

⁴ Vlerësimet tjera në 48.3% të popullatës (Vlerësimi për zhvillimin rapid të komunave të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, 2002-2004, f.158).

⁵ Ministria e Ekonomisë dhe Financave 'Vlerësimi për zhvillimin rapid të komunave të Kosovës, 2002-2004,' f. 157-8.

⁶ Komuna e Gjakovës, Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, 2010. Kjo përfshin vetëm të punësuarit e rexhistruar (jo në sektorin jo formal, që duket i konsiderueshëm bazuar në hulumtimin e IKS-it).

⁷ Drejtorati i Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Gjakovës, 2010.

⁸ UNDP, *Human Development Report for Kosovo-The Rise of the Citizen: Challenges and Choices*, 2004, pp. 121-124. Bazuar në shifrat zyrtare, shkalla e papunësisë së rexhistruar në Gjakovë është vetëm 19.3%. Megjithatë, te vetmet shifra zyrtare të papunësisë të disponuara janë të bazuara në numrin e të rexhistruarve pranë Qendres Rexhionale të Punësimi(QRP). Meqenëse rexhistrimi bëhet shumë rrallë, shumë njerëzit nuk rexhistrohen dhe kështu nuk llogariten si të papunësuar.

⁹ Kalkuluar nga IKS duke mbledhur të gjitha kategoritë e pranuesve të skemës së mirëqenies sociale. Duhet vërejtur se numri i pranuesve individual mund të jetë më i madh për shkak se pranues të ndihmës sociale për familjet e martirëve janë më tepër individ.

¹⁰ Individëd brenda familjes që pranojnë asistencë sociale që nga Dhjetori i vitit 2009, Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), Statistikat për Mireqenie Sociale, 2009 f.25.

¹¹ Numri individual i pranuesve nga dhjetori i vitit 2009 (ESK), Statistikat për Mirëqenie Sociale, 2009, f.9.

Më vonë atë pasdite, udhëtuam në Koloninë Rome, e cila gjendet vetëm disa kilometra larg qendrës së Gjakovës. Hyrja e lagjës dhe rrugët me baltë janë të stërbushura me mbeturina. Përkundër kushteve të mjera të jetesës, të rinjtë romë, ashkalinj dhe egjiptas janë të mençur dhe energjik. Ata flasin rreth shpresave të tyre për një jetë më të mirë duke qenë njëkohësisht të vetdijshëm për rëndësinë që mban në vete vazhdimi i shkollimit. Megjithatë, edhe për një të re inteligjente siç është 14-vjeçarja Mile, normat shoqërore nënkuptojnë që ‘martesa e mirë’ është e vetmja shpresë që një femër e re mund ta ketë për një të ardhme më të mirë. Përkundër përpjekjeve të tyre për të ndikuar në ndryshime, edhe ata ndihen të injoruar nga zyrtarët, përfshirë këtu ‘përfaqësuesin’ e tyre komunal.

Politikat në nivelin komunal janë kyçe për t’i trajtuar mangësitë e të varfërve, pakicave, rinisë dhe femrave. Në ato fusha ku politikat kombëtare mund të tregohen si joadekuate, ‘zhvillimi i bazuar në zonë’ përmban në vete një qasje më holistike ku politikat merren me nevoja të caktuara në një zonë specifike gjeografike, siç është Gjakova.¹⁴ Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, i përafuar me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale,¹⁵ promovon zhvillimin e bazuar në zonë. Megjithatë, në diskutimet tona me banorët e Gjakovës kemi vërejtur zbrazëti në mes të politikave në letër dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në përputhje me politikën zhvillimore të Bashkimit Evropian dhe standardeve të anëtarësimit, ky dokument ekzaminon se **cilat ndryshime të politikave do të mund të çonin në rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimin njerëzor të bazuar në zonë në Gjakovë, duke e përdorur qasjen e mbështetur në të drejtat e njeriut.**

Por para se të nisemi në këtë udhëtim, t’i themi disa fjalë për terminologjinë dhe metodologjinë që kemi përdorur në këtë studim. Së pari, mënyra se si definohet dhe matet zhvillimi ka implikime të politikave. Përtej qasjeve të ngushta monetare që nuk arrijnë ti marrin parasysh shumë aspekte tjera të mirëqenies, këtu kemi përfshirë një kuptim më të gjerë të **zhvillimit**, siç përshkruhet edhe në defincionin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së:

¹² Numri individual i pranuesve në 2009 (ESK, Statistikat për Mirëqenie Sociale, 2009, f.12.

¹³ Kjo përfshin invalidë individual të luftës dhe familjet e martirëve nga Dhjetori i 2009 (*Statistikat e Mirëqenies Sociale 2009*, f.13)

¹⁴ UNDP, *Në Rrezik: Romët dhe të Zhvendosurit në Evropën Juglindore*, 2006, f. 6.

¹⁵ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-40. Shih: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,249>.

Proces gjithpërfshirës ekonomik, shoqëror, kulturor dhe politik, i cili synon përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së tërë popullatës dhe të gjithë individëve bazuar në pjesëmarrjen e tyre aktive, të lirë dhe domethënëse në zhvillim dhe në shpërndarjen korrekte të përfitimeve që burojnë nga ajo.¹⁶

BE-ja kombinon një nocion të ngjashëm të zhvillimit njerëzor dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike me **kornizën e bazuar në të drejtat e njeriut**. Për BE-në, të drejtat shoqërore, kulturore, civile, politike dhe ekonomike janë të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërthurura. Zotëruesit e të drejtave (qytetarët) dhe bartësit e detyrave (institucionet dhe përfaqësuesit e tyre) janë të obliguar ta respektojnë ligjin për të drejtat e njeriut gjatë proceseve zhvillimore.¹⁷ Diskriminimi shihet si shkelje e ligjit për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grupeve jashtëzakonisht të ndjeshme, të përjashtuara dhe të diskriminuara trajtohen si prioritete.

Prandaj, respektimi i të drejtave të njeriut është parakusht për anëtarësimin përfundimtar të Kosovës në BE. Marrëveshja e Partneritetit Evropian identifikon prioritetet të cilat duhet t'i përmbush Kosova drejt integritimit evropian, si pjesë e Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit (PSA).¹⁸ Planet e Veprimtimit të Partneritetit Evropian (PVPE) shërbejnë si 'dokumente pune' për zbatimin e marrëveshjeve të partneritetit.¹⁹ Raportet vjetore monitoruese të

¹⁶ Rez. e AP-së. 41/128, 4 Dhjetor 1986.

¹⁷ Dallimi në mes nevojës (p.sh. 'qasjes së nevojave bazike' ndaj zhvillimit) dhe të drejtës është se nevojat e papërbushura nënkuptojnë pakënaqësi, por kompensimi për të drejtat e shkelura mund të kërkohet në mënyrë ligjore. Autoritetet duhet ti respektojnë të drejtat, derisa nuk kanë përgjegjësi ligjore ti adresojnë nevojat.

¹⁸ Kosova duhet ti përmbush obligimet e saj politike përfshirë këtu demokracinë dhe sundimin e ligjit; të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave; dhe çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare. Kërkesat ekonomike dhe standardet evropiane përfshijnë tregun e brendshëm, politikat sektoriale, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

¹⁹ Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në bashkëpunim me UNMIK-un hartuan PVPE-të në vitin 2005 dhe 2006, bazuar në Kriteret e Kopenhagës dhe *Acquis Communautaire*. PVPE në vitin 2006 'mishëroi' Standardet për Kosovën të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në 'punën për integrimin evropian të Kosovës.' PVPE duhej të kishte 'lidhje të ngushtë tematike' me Strategjinë dhe Planin Zhvillimor të Kosovës të hartuar në vitin 2006. Strategjia dhe Plani nuk u miratuan kurrë, por PVPE e vitit 2006 thotë që politikat zhvillimore kombëtare do të përqendrohen në përmbushjen e kritereve drejt integritimit evropian ('Plani Kosovar i Veprimtimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian', 2006, f.9).

Komisionit Evropian, të bazuara në PVPE-të, e masin progresin e Kosovës në përmbushjen e standardeve evropiane.

Komuna e Gjakovës është zgjedhur si lokacion gjeografik për rastin studimor të zhvillimit të bazuar në zonë drejt anëtarësimit

‘Gjakova është bërë pikë e verbër për Kosovën.’

në BE, duke marrë parasysh rrethanat pak a shumë të veçanta si dhe popullatën jashtëzakonisht të ndjeshme të kësaj komune. Në fjalët e një respondenti, ‘Gjakova është bërë pikë e verbër për Kosovën.’²⁰ Gjatë këtij rasti studimor, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ka përdorur metoda të përziera, përfshirë këtu: më tepër se 60 intervista të hollësishme me hisedarë kyç; katër grupe të studimit me të rinjtë, zonjat e shtëpive si dhe të rinjë të komuniteteve roma, ashkaliñ dhe egjiptas; një studim të 53 bizneseve;²¹ si dhe intervista grupore me afariste, përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) dhe me Ekipin Monitorues të Kuvendit Komunal. Hulumtimet fillestare janë shoqëruar me burime sekondare, përfshirë këtu konsultimin e ligjeve, politikave, librave, botimeve, mediave dhe dokumenteve relevante. Dokumenti pastaj është diskutuar me hisedarë relevant gjatë punëtorive në Gjakovë dhe Prishtinë. Nëpërmjet këtyre ‘kontrolleve nga pjesëmarrësit,’ hisedarët i vërtetuan gjetjet e hulumtimit si dhe ofruan sugjerime disa prej të cilave janë përfshirë në këtë punim.

Kapitulli i parë shqyrton se cilat ndryshime të politikave do të mund ta vendosin Gjakovën në rrugë drejt rritjes ekonomike, duke marrë parasysh historinë e saj si qendër e prodhimit dhe tregtisë, tokën pjellore tashmë të deindustrializuar dhe qytetin e shkatërruar nga lufta. Kapitulli i dytë shqyrton më gjerësisht politikën drejt zhvillimit njerëzor, duke përdorur qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut. Ky kapitull përqendrohet kryesisht në grupet e ndjeshme, të drejtat e të cilave marrin vëmendje të posaçme nga BE-ja:²² të rinjtë, femrat dhe pakicat rome, ashkali dhe egjiptase. Në përfundim të punimit janë rishikuar rekomandimet e politikave drejt zhvillimit të Gjakovës në përputhje me standardet e anëtarësimit në BE.

²⁰ Intervista e IKS me Muharrem Prizreni, Drejtor Ekzekutiv i OJQ Fahri Vraniqi, Gjakovë, 12 Gusht 2010.

²¹ Këto gjendeshin në dy rrugët kryesore të qytetit të Gjakovës: *Nëna Tereze* and *Qarshija e Vjetër*.

²² Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së, ‘Evropa nga A në Z: Promovimi i të Drejtave të Njeriut,’ at http://euicc-ks.com/en/eu_and_kosovo/europa_a_to_z, shikuar më 4 Mars 2011. Kjo qartëzohet edhe në PVPE që u diskutua më vonë.

I. NË RRUGË DREJT RITJES EKONOMIKE

Në këtë kapitull, do të udhëtojmë nëpër historinë e Gjakovës: nga një qendër tregtare në kohën e Perandorisë Osmane, në zonë qendrorë industriale në kohën e ish-Jugosllavisë e deri te një zonë e varfëruar nga politikat represive të regjimit të Millosheviqit dhe nga lufta e fundit. Në kornizën e anëtarësimit në BE, pastaj do ta ekzaminojmë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore; shkallën në të cilën sektori privat po e udhëheq rritjen ekonomike në Gjakovë; si dhe potencialin rritës të sektorit të bujqësisë.

Historikisht, qyteti i Gjakovës është zhvilluar gjatë shekullit të XV-të rreth Xhamisë së Hadumit, e ndërtuar në shekullin e XIV-të. Për shkak të shfrytëzimit të rrugëve nga Perandoria Osmane për tregti sa në perendim e sa në lindje, ky qytet i Ballkanit u shndërrua në një treg të pasur dhe qendër e punës së dorës. Qendra kulturore, arsimore dhe fetare kishte librarinë e saj, shkollën si dhe *Qarshinë e Madhe*.²³ E ndërtuar nga *gjakovarët*, kompleksi ‘nuk ishte importuar nga jashtë,’ por ‘ishte monument i kulturës shqiptare.’²⁴ Në vitin 1662, një vizitor kështu e përshkruante:

Jakova ka 2,000 shtëpi të dekoruara dhe të shpërndara në një fushë të gjerë. Ka dy xhami të bukura, xhami pa minare [*mesjide*], dhe hane të mbështjellura me plumb. Ka një banjo të bukur publike [*hamam*] dhe rreth 300 shitore me 1,000 lloje zanatesh.²⁵

Gjatë shekujve XVI dhe XVII ekonomia e Gjakovës u zhvillua rreth Çarshisë së Vjetër. Stallet e saj të drurit me grille të gdhendura ishin të njohura për përpunimin e metalit, shalave, filigranit, dorëzave të dekoruara të arit të shpatave si dhe për prodhimin dhe dekorimin e armëve.²⁶ Dy urat (*Tabakve* dhe *Terzive*) e ndërtuara në shekullin XVI-të, edhe sot mund të shihen buzë rrugës. Ato e lidhnin Gjakovën me Prizrenin dhe Shkodrën, duke formuar kështu një rrugë të rëndësishme të kalimit në Ballkan. Produktet e Gjakovës, duke përfshirë këtu edhe leshin dhe mëndafshin e përpunuar, eksportoheshin

²³ Professor Riedlemajer, i cituar në Masar Rizvanolli, *Pazari i Madh në Gjakovë*, Shoqata e Intelektualeve *Jakova*, Gjakovë, 2009, f. 66.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ Evliya Çelebi, *Evliya Çelebi's Book of Travels: Evliya Çelebi in Albania and Adjacent Regions Kosovo, Montenegro*, The Relevant Sections of the Seyahatname, trans. and ed. Robert Dankoff, Leiden and Boston: 2000.

²⁶ *Po aty*.

në mbarë Evropën Juglindore dhe Qendrore. Për shekuj me radhë, Gjakova ishte qendër e prodhimit dhe tregtisë.

Gjatë shekullit XIX-të Perandoria Osmane ishte e njohur si një regjion i madh ekonomik (i ngjajshëm me BE-në sot). Rrugët tregtare të Osmanëve vazhduan të ishin lindja dhe perëndimi, të lidhura përmes Gjakovës. Megjithatë, luftërat ballkanike gjatë shekullit të XX-të e shkatërruan Perandorinë Osmane dhe krijuan hapësira për influencë të reja. Perandoria Austro-Hungareze financoi ndërtimin e hekurudhës së Selanikut përmes Kosovës me dalje në Shkup. Rruga e ndryshoi trendin e zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe avantazhi i mëparshëm gjeografik i Gjakovës u zhduk. Duke mos qenë të lidhur me rrugë dhe asfalte kryesore, prosperiteti shekullor i industrisë dhe tregut pësoi rënie.

Pas luftës së dytë botërore, politikanët gjakovarë posaçërisht u involvuan në Lidhjen Komuniste Jugosllave. Kjo kontribuoi në ngritjen e një elite me influencë, e cila pranoi pozita të larta brenda Partisë Komuniste në strukturat udhëheqëse të Kosovës dhe mbarë Jugosllavisë.²⁷ Ata ishin të gatshëm të tërheqnin investime për ndërmarrjet e reja shoqërore në Gjakovë të involvuara në industrinë prodhuese. “Gjakovarët” gjithashtu ndërtuan një reputacion në mesin e shumë kosovarëve të arsimuar dhe kontribuan në themelimin e Universitetit të Prishtinës.²⁸ Kjo mendohet se ka qenë thikë me dy teha pasi që arsimimi terciar së bashku me qeverinë dhe vendet e punës tani ndodheshin në Prishtinë. Mundësitë e punësimit dhe arsimimit i tërhoqën gjakovarët në

²⁷ Lista e Gjakovarëve që mbanin pozita ishte e gjatë. Për shembull, Fadil Hoxha ishte President i Asambles së Krahinës Autonome të Kosovës. Në vitin 1967 ai ishte caktuar në Kryesinë e Partisë Komuniste Jugosllave dhe në vitin 1974 i ishte bashkuar Kryesisë Federale. Në vitin 1978-9 ai ishte pjesë e rotacionit të postit të zëvendës presidentit të Presidencës së Jugosllavisë që ishte posti më i lartë gjatë udhëheqjes së Tito-s. Mahmut Bakalli e udhëhoqi Lidhjen Komuniste të Kosovës që nga viti 1961, e më vonë udhëhoqi Partinë në Prishtinë. Më vonë ishte zgjedhur në Komitetin Qendror të Partisë në Serbi dhe në Kryesinë e Komitetit Qendror të Ligës Komuniste të Jugosllavisë. Bakalli udhëhoqi partinë në Kosovë nga fundi i 1970 deri në fillimin e 1980. Ai dha dorëheqje pas disa mos marrëveshjeve me autoritetet jugosllave, për mënyrën e sjelljes ndaj studentëve në protestat e 1981. Veli Deva kryesoi Komitetin Qendror të Lidhjes Komuniste të Kosovës prej vitit 1965 deri në vitin 1971 dhe përsëri prej vitit 1981 deri në vitin 1982 (gjithashtu ishte sekretar gjatë vitit 1966). Imer Pula ishte kryesues i Këshillit Ekzekutiv i Komitetit Popullor të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (apo kryeministër i Kosovës) prej vitit 1982 deri në vitin 1984. Xhavit Nimani shërbeu si President i Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës prej Marsit 1974 deri në vitin 1981.

²⁸ Dy nga pesë rektorët e Universitetit të Prishtinës nga viti 1970 deri në vitin 1984 ishin nga Gjakova (Universiteti i Prishtinës, Monografi e Universitetit të Prishtinës 1970-2005, Prishtinë, 2005).

kryeqytet. Megjithatë, gjatë komunizmit Gjakova mbeti qendër e industrisë dhe tregut.

Në vitet e 1970-ta, Gjakova ishte njëri ndër qytetet më të industrializuara në Jugosllavi, me shkallën më të lartë të punësimit për kokë banori. Nga viti 1975 deri në vitin 1990, ndërmarrjet e saja shoqërore kishin 16,000 punëtorë dhe prodhonin një gamë të gjërë produktesh.²⁹ Ndërmarrja *Jatex* (e cila më parë quhej *Napredak*) prodhonte tekstile të ndryshme që shiteshin në shitoret e saj anëmbanë ish-Jugosllavisë. Ndërmarrja e madhe elektronike nga Sllovenia, *Gorenje*, udhëhiqte një ndërmarrje ndihmëse në Gjakovë të quajtur *Elektromotori* e cila prodhonte motore elektronike për makinat për larjen e rrobave dhe për produkte tjera shtëpiake. Përveç kësaj, *Elektromotori* kishte marrëveshje bilaterale të bashkëpunimit me një ndërmarrje italiane në vitet e 80-ta.³⁰ *Metaliku* prodhonte produkte të ndryshme të metalit siç janë telat dhe gypat, derisa *Ereniku* po ndërtonte një biznes mjaft të mirë të pijeve.³¹ Ndërmarrjet më të mëdha shoqërore në Gjakovë kishin arritur të dëpërtonin përtej Jugosllavisë, në tregun evropian, amerikan dhe kanadez.³² Me një vlerë vjetore të eksportit prej rreth \$100-200 milion, këto ndërmarrje shoqërore përfaqësonin zemrën e industrializimit dhe pasurisë së Gjakovës.

Megjithatë, në vitet e 70-ta, Jugosllavia pësoi një rënie ekonomike. Kriza ekonomike erdhi si rezultat i përzjerjes fatale të investimeve të pakoordinuara, mosbalancimeve tregtare dhe borxhit, e cila u përkeqësua edhe më tej nga ngritja e çmimit të naftës në vitin 1973. Kjo çoi në inflacion dhe ndryshim të rritur në mes kosos së jetesës dhe pagave ekzistuese.³³ Në vitin 1981, deficitin i Jugosllavisë kishte arritur në \$19.2 miliard.

²⁹ Përgatitur nga CBDC me mbështetje financiare nga United Nations Development Programme (UNDP), Norwegian Government and United Nations Volunteers (UNV), 'Sustainable Development Strategy of Gjakovë/Dakovica Municipality, 2007-2015 Based on the Millennium Development Goals (MDGs)', 2007, f.32.

³⁰ *Elektromotori* themeloi një firmë të quajtur GEMI në Milano, Itali; 90 përqind ishte në pronësi të *Elektromotorit* dhe 10 përqind në pronësi të partnerëve të tyre italian. Ndërmarrja hapi edhe një firmë në Stamboll, Turqi, të quajtur EXIM me përqindjen e njëjtë të pronësisë (Intervista e IKS me Albert Baraku, menaxher i dikurshëm në *Elektromotori* dhe njëri prej themeluesve të Bankës Ekonomike, 7 Korrik 2010.

³¹ Qendra për Zhvillimin e Bizneseve të Komunitetit (CBDC), *Mundësitë për Investim në Gjakovë*, 2006, f. 4.

³² IKS intervistat me drejtor të dikurshëm dhe aktual të NSH-ve në Gjakovë, Prill-Korrik, 2010.

³³ Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel: The disintegration of Yugoslavia from the death of Tito to the fall of Milosevic*, Boulder: Westview Press, 2002, pp. 9-10.

Pasojat sociale dhe politike të nacionalizmit serb në rritje pas vdekjes së Titos çuan në mosinvestime tjera në industrinë e Kosovës. Në vitin 1989, Serbia revokoi statusin e Kosovës si krahinë autonome në federatën jugosllave. Pas pak, Kuvendi i Serbisë miratoi ligjin për ‘marrëdhëniet e punës’ i cili çoi në largimin masiv nga puna të punëtorëve shqiptarë, përfshirë këtu edhe mijëra gjakovarë.³⁴ Masat represive të regjimit të Millosheviqit në mënyrë efektive e deindustrializuan Gjakovën dhe e kthyen këtë qytet në fazën para industrializimit.³⁵

Për ta bërë këtë edhe më keq, milicia dhe paramilitarët serb i vunë flakën Çarshisë së Vjetër natën e parë të bombardimeve të NATO-së gjatë luftës së vitit 1999.³⁶ Zjarri e kishte gëlltatur qendrën historike të Gjakovës. Fal përkrahjes nga donatorët ndërkombëtarë, qendra e qytetit është restauruar dhe sot ka pothuajse pamjen e saj origjinale. Megjithatë sot, biznesi në çarshinë e dikurshme përplot gumëzhim është më i ngadalshëm dhe aspektet tjera të ekonomisë së dikurshme të zhvilluar të Gjakovës lëngojnë në një gjendje të mjerueshme. Prodhimtaria industriale thuhet nuk ekziston fare, kooperativat bujqësore janë dezintegruar dhe ekonomia e Gjakovës i është kthyer në masë të madhe bujqësisë vetanake.

Më gjërësisht me bruto produktin vendor prej €1,761, Kosova ka njerën prej ekonomive më të varfra në Evropë.³⁷ Krahasuar me gjashtë regjionet tjera të Kosovës, Gjakova renditet e treta për papunësinë më të madhe duke qëndruar pas Mitrovicës (45.3%) dhe Ferizajit (54.4%).³⁸ Të drejtat e pazgjidhura pronësore dhe sundimi i dobët i ligjit i kanë dekurajuar investimet e huaja direkte.³⁹ Në fakt, Të Bërit Biznes 2010 e rendit Kosovën në vendin e 113-të, më ulët se në vitin 2009 (107), për shkak të mjedisit jo të favorshëm rregullativ për operimin e bizneseve.⁴⁰ Në këtë klimë të mjerueshme

³⁴ Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Pluto Press, 2000, p. 74.

³⁵ Për më tepër rreth deindustrializimit të Kosovës, shih Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), ‘Dilema Otomane’, 2002. Për ndikimin e masave të regjimit të Millosheviqit shih, Clark, 2000, ose Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, London: Macmillan, 1998, pp. 346-347.

³⁶ Më 24 Mars 1999, NATO-ja lansoi ndërhyrjen ushtarake për ta ndaluar pastrimin etnik në Kosovë.

³⁷ Banka Botërore, ‘World Bank Interim Strategy Note 2009 for the Financial Years 2010, 2011,’ f. 7.

³⁸ Banka Botërore, ‘World Bank, *Kosovo Poverty Assessment Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty*, Prishtina: World Bank, October 2007, p. 20.

³⁹ Banka Botërore, *Zbërthimi i Potencialit Për Rritje: Politikat, Veprimet Strategjike*, Prill 2010, f. vii.

⁴⁰ Banka Botërore, ‘Të Bërit Biznes 2010,’ në: www.doingbusiness.org.

ekonomike, çfarë hapa mund të ndërmarrin autoritetet komunale dhe qendrore në mënyrë që ta vendosin Gjakovën në rrugë drejt rritjes ekonomike?

Pengesat në Procesin e Privatizimit

Kur Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) morri përsipër udhëheqjen e Kosovës në fund të vitit 1999, i tërë sektori ekonomik, përfshirë këtu edhe fatin e NSH-ve, kaluan nën përgjegjësinë e UNMIK-ut.⁴¹ Privatizimi u zgjodh si drejtimi i duhur për zhvillimin ekonomik të Kosovës.⁴² Në vitin 2002 u themelua Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM), e cila kishte autoritetin të vlerësonte, administronte dhe të privatizonte ndërmarrjet shoqërore, si dhe të administronte ndërmarrjet publike (NP-të).⁴³ Shumë shpresa për ringjallje ekonomike dhe për rritjen e ekonomisë private janë mbështetur në procesin e privatizimit.⁴⁴ Një numër relativisht i madh i aseteve të NSH-ve në Gjakovë, përfshirë këtu tokat dhe ndërtesat strategjike, prandaj pritet që të shërbejnë posaçërisht si potencial i pazbuluar për ringjalljen ekonomike të Gjakovës. Në rrugën drejt anëtarësimit në BE, privatizimi ishte identifikuar poashtu si komponent kyç i PVPE-së së Kosovës drejt rritjes ekonomike: ‘Në mënyrë domethënëse të përparojë privatizimin e ndërmarrjeve të dikurshme shoqërore në përputhje me orarin e Agjencisë së Mirëbesimit.’⁴⁵

Megjithatë, procesi i privatizimit në Gjakovë hasi në një pengesë të madhe. Shumë nga NSH-të e Gjakovës pohuan që ato janë tashmë të ‘transformuara,’ do të thotë të privatizuara gjatë viteve të 1990-ta, bazuar në ‘ligjet e Markoviqit,’ që ishin atëherë në fuqi.⁴⁶ Ato ligje parashihnin transferimin

⁴¹ UNMIK është administratë e përkohshme civile nën autoritetin e OKB-së, e themeluar me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit më 10 qershor 1999.

⁴² Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) përdori procedurën ‘spin-off’ në të cilën një ndërmarrje e re do të formohej në formë të ndërmarrjes së aksioneve të përbashkëta të e cila do të barteshin të gjitha asetet e NSH-së së vjetër. Kjo ndërmarrje e re do të tenderohej për shitje derisa ndërmarrja e vjetër do ti ruante të gjitha detyrimet. Paratë e ruajtura në mirëbesim do të përdroreshin për zgjidhjen e pohimeve të kreditorëve mbi NSH-në e vjetër (AKM, *Rishikim i Mekanizmit të Privatizimit (nën AKM)*, në <http://kta-kosovo.org>).

⁴³ Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit.

⁴⁴ Intervistat e IKS me qytetarët e Komunës së Gjakovës, Mars-Shtator 2010.

⁴⁵ Republika e Kosovës. ‘Plani i Veprimit 2010 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën.’ Prishtinë: Korrik 2010.f. 25/73.

⁴⁶ *Ligji për Ndërmarrjet 1989*, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 77/88; dhe *Ligji mbi Kapitalin Shoqëror 1990*, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 8/20/90. Menaxhmenti i NSH-së mund të vendoste ta ndryshojë statusin e saj në një ndërmarrje me aksione të përbashkëta dhe ti shesë aksionet (*Ligji për Ndërmarrjet 1989*, Neni 120).

gradual të kapitalit shoqëror në kapital privat nëpërmjet shitjes së aksioneve të punëtorëve të fabrikës. Në këtë mënyrë, një kompani do të transformohej në kompani me aksione të përbashkëta në pronësi private të menaxhmentit dhe punëtorëve të vet.⁴⁷ Nëpërmjet këtij procesi, disa NSH kanë arritur t'i minimizojnë masat e përkohshme të regjimit të Millosheviqit, të cilat ndërhyjnë në qeverisjen e NSH-ve duke përjashtuar nga puna punëtorët shqiptarë.⁴⁸ Edhe pse këtyre kompanive iu mundësua transformimi që të zgjasnin jetëgjatësinë e tyre, deri në fund të viteve 1990 klima e gjërë politike bëri që shumë prej tyre t'i mbyllnin dyert po ashtu.

Meqë transformimi i kapitalit legalisht mund të zgjas deri në dhjetë vite, sot mbetet e paqartë nëse çdo NSH ka kaluar nëpër procedurat e nevojshme ligjore.⁴⁹ Përveç kësaj, menjëherë pas arritjes së tij, UNMIK-u vendosi që legjislacioni i pasluftës në Kosovë do t'i përfshinte vetëm ligje që janë miratuar para 23 marsit 1989. Ky akt i bëri 'ligjet e Markoviqit' kryesisht të pavlefshme.⁵⁰ Ndërmarrjet e dikurshme shoqërore që pohojnë se janë transformuar (privatizuar) një herë kanë ngecur në një qark të kontesteve për pronësi me AKM-në dhe me pasardhësen e saj Agjencionin Kosovar për Privatizim (AKP).⁵¹ Duke qenë që një degë e ish gjykatës komerciale të Kosovës kishte seli në Gjakovë, shumica e ndërmarrjeve nga komuna e kanë përdorur modelin e transformimit. Kështu që, ky problem i pa zgjidhur i statuseve ka qenë unik për Gjakovën.

Vendimin për këtë transformim duhej ta merrte trupi menaxhues (Neni 187a). Ndërmarrja duhej të regjistrohej në një gjykatë relevante (Neni 184) (p.sh. Gjykata Ekonomike në Gjakovë). Ndërmarrja duhej të shitej në vlerën e tregut, e prandaj duhet të vlerësohej çmimi i ndërmarrjes (*Ligji mbi Kapitalin Shoqëror*, Neni 4). Menaxhmenti pastaj mund të lëshonte aksione (Neni 1a); për punëtorët aktual dhe të dikurshëm parashihej zbritja e çmimit të aksioneve (Neni 1c).

⁴⁷ M. Uvalic, *Privatizimi dhe Qeverisja e Korporatave në Serbi (RF Jugosllavi)*, 2001, f. 10.

⁴⁸ Ka pasur pohime që transformimi është inicuar kryesisht për t'iu shmangur kontrollit serb mbi menaxhimin e NSH-ve (intervistat e IKS me Shkumbin Bicaj, ish-Zv. Drejtor i AKM-së, 14 Shtator 2010 dhe Ali Buza, drejtor i *Elektromotori*, 15 Qershor 2010, në mes tjerësh).

⁴⁹ *Ligji për Kapitalin Shoqëror 1990*, Neni 1h.

⁵⁰ Dominik Zaum, *The Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International Statebuilding*, Oxford University Press, 2007, p. 155.

⁵¹ APK-ja rregullohet nga Rregullorja e amendementuar e UNMIK-ut 2002/12. Të gjitha asetet dhe detyrimet e AKM-së i janë bartur APK-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e APK-së nënvizohen në Ligjin Nr. 03/L-067 (shih: <http://www.pak-ks.org>). Drejtorët pohojnë që kanë dëshmuar se privatizimi ka ndodhur në mënyrë ligjore gjatë viteve 1990. Megjithatë, ish-zyrtarët e AKM-së thonë që drejtorët kurrë nuk kanë paraqitur dokumente adekuate, kanë refuzuar të bashkëpunojnë dhe e kanë bllokuar progresin (intervistat e IKS me Shaban Deva, drejtor i *Dukagjini* JSC, 12 Prill 2010; Gazmend Tuzi, drejtor i *JATEX*, 15 Qershor 2010; Shkumbin Bicaj, ish Zv. Drejtor i AKM-së, dhe ish-anëtar i stafit në AKM, 14 Shtator 2010).

Disa nga ish-ndërmarrjet më të mëdha shoqërore e dërguan rastin te Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme.⁵² APK-ja më vonë njoftoi që privatizimi i tri kompanive *Emin Duraku Edico*, *Deva Chrome dhe Kompleksi Industrial Emin Duraku* do të bëhej në tetor të vitit 2010.⁵³ Megjithatë, Dhoma e Veçantë mbetet të gjykojë nëse mund të vazhdojë privatizimi.⁵⁴ Ndërmarrjet tjera siç janë *Metaliku* dhe *Ereniku* janë ende plotësisht joaktive dhe në pritje të APK-së që ta përcaktoj statusin e tyre.⁵⁵

⁵² Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për Çështjet që ndërlidhen me AKM-në u themelua sipas rregullores së UNMIK-ut 2002/13.

⁵³ Shih uebfaqen e APK-së: <http://www.pak-ks.org/?id=58>.

⁵⁴ Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për Çështjet që ndërlidhen me AKM-në, rasti SÇ-10-0215 (*Jatex vs. PAK*) dhe rasti SÇ-10-0141 (*Deva-Holding, Deva-Gazi, Deva-Commerce, Separacioni, Deva-Transhpedit vs. PAK*).

⁵⁵ Si pjesë e konglomeratit Trepça, e ardhmja e *Metalikut* varet nga vendimi i Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për moratoriumin mbi Trepçën; AKM-ja vendosi moratoriumin mbi Trepçën për shkak të kërkesave të kreditorëve nga vitet 1990 (komunikimi i IKS me Mrika

Table 1. Statusi i NSH-ve të Gjakovës

Nr.	Emri i Kompanive	Statusi
1	Ereniku	E kontestuar
2	Ereniku Industry	E kontestuar
3	Ereniku Vixhinia	E kontestuar
4	Ag Coop Rogova	E kontestuar
5	Ag Coop Bistrashini	E kontestuar
6	Ag Coop Demiani	E kontestuar
7	Ag Coop Gërgoci	E kontestuar
8	Coop Ponoshec	E kontestuar
9	Coop Rogovë	E kontestuar
10	9 Nentori	E kontestuar
11	Forest Economy	E kontestuar
12	Metaliku	E kontestuar
13	Unimetali	E kontestuar
14	Veterinary Station Gjakovë	E kontestuar
15	Enti i Projektimit 'Ening'	E kontestuar
16	Ereniku Trading	E kontestuar
17	Kosovatrans Gjakova	E kontestuar
18	Ag Coop 'Novosela'	E kontestuar
19	Gjeodezia N.sh	E kontestuar
20	Barnaret Gjakovë	E kontestuar
21	Mulliri	E Privatizuar
22	Beci	E Privatizuar
23	Ereniku Poultry Farm	E Privatizuar
24	Stacioni Bujqësorë Gjakovë	E Privatizuar
25	Coop Skivjan	E Privatizuar
26	Ereniku- Prodhimtaria Primare	E Privatizuar
27	IMN	E Privatizuar
28	Agimi – Mishi	E Privatizuar
29	NewCo Deva Chrome Fabrika për LLC	E ri-tenderuar në Valën e 49-të
30	Auto House Kompresori	E Privatizuar
31	Emin Duraku HC	Duke e pritur vendimin e DHVGJS
32	Jatex HC	E kontestuar
33	NewCo Emin Duraku Edico	Duke e pritur vendimin e DHVGJS
34	NHTT Pashtriku	E Privatizuar
35	Agimi	E Privatizuar
36	Modeli HC	E Privatizuar
37	Auto-Moto Start	E Privatizuar
38	Dukagjini	Statusi i njohur
39	Elektromotori	Statusi i njohur

Në përgjithësi, nga 39 ish-NSH në Gjakovë, vetëm 13 janë privatizuar deri tani, dy janë pranuar si të transformuara (privatizuara), një, *Deva Fabrika e Përpunimit të Kromit* SH.P.K, do të ritenderohet në valën e 49-të të privatizimit dhe 23 ndërmarrje ende kanë status të kontestuar (shih Tabelën 1).⁵⁶ Të bllokuara në konteste rreth statusit të tyre, ish-ndërmarrjet më të mëdha shoqërore të Gjakovës kanë mbetur në baltë dhe asnjëra prej tyre nuk merret me prodhimtari aktualisht. Një numër i vogël i punëtorëve të cilët ende punojnë aty paguhën nga të hyrat e dhënies me qira të ndërtesave dhe shitoreve të NSH-ve (shih Tabelën 2 në faqen vijuese).

Meqë privatizimi i dy të tretave të NSH-ve të Gjakovës është shtyer për më tepër se tetë vite, punëtorët e dikurshëm dhe ata aktual nuk e dinë nëse do të kenë hise në aksionet e ndërmarrjeve të tyre, pagesën prej 20 përqind, vend të ri të punës pas privatizimit apo asgjë fare. Derisa të definohet statusi ligjor i këtyre ndërmarrjeve, ata nuk kanë qasje as në kapitalin për investime dhe zhvillim. Në këtë drejtim, në përputhje me PVPE-në, APK-ja duhet ta përshpejtoj procesin e privatizimit.⁵⁷

Tahiri, Zv. Drejtore e AKP-së, 16 Shtator 2010).

⁵⁶ Agjencia Kosovare për Privatizim (AKP), lista e NSH-ve në komunën e Gjakovës (Komunikim i IKS-it me e-mail me zyrën për informim publik të AKP-së, 15 Mars 2011). Numri i përgjithshëm i NSH-ve në Gjakovë ndryshon në varësi të burimit. Sipas raportit të UNMIK-ut 2002, Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë (ish NSH-të dhe aktuale në Gjakovë), 61 NSH janë identifikuar në Gjakovë, ndërsa Strategjia për zhvillimin e Qëndrueshëm e komunës së Gjakovës liston 48 ish NSH dhe 9 aktuale. Numri gjithashtu varet nëse NSH-të që kanë krijuar filiale, si *Deva* dhe *Ereniku*, numërohen si një kompani apo të gjitha filialet numërohen ndaras. AKP-ja numëron vetëm holding company, por kjo mund të jetë çorientuese ngase filialet shiten shpesh dhe veç e veç.

⁵⁷ Republika e Kosovës, 'Plani i Veprimit 2010 për Zbatimin e Partneritetit Evropian të Kosovës (PVPE), Prishtinë: Korrik 2010, prioritet 52.

Tabela 2. Aktiviteti i NSH-ve të përzgjedhura në Gjakovë

NSH	Viti i themelimit	Prodhimtari e mëhershme	Punëtorë në 1990	Aktiviteti aktual	Punëtorë në 2010
<i>Jatex</i> ⁵⁸	1947	Prodhimtari e tekstit; tregti	1,888	Dhënia me qira e shitoreve	70
<i>Metaliku</i> ⁵⁹	-	Prodhimtari e produkteve metalike	1,530	Joaktive	8
<i>Deva</i> ⁶⁰	1949	Xehet minerale; furnizimi me gaz	159	Në proces të privatizimit	48
<i>Ereniku</i> ⁶¹	1961	Prodhimtari e produkteve ushqimore	1,356	Dhënie më qira e hapësirave	98
<i>Emin Duraku</i>	1959/60	Prodhimtari e tekstit	2,850	Joaktive; Kontest gjyqësor	501

Burimi: Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gjakovës, 2010; intervistat e IKS me drejtorët e NSH-ve

Në të njëjtën kohë, njohja e disa NSH-ve si veç më të transformuara (privatizuara) nuk siguron aktivitet ekonomike drejt rritjes. *Elektromotori* dëshmoi që është privatizuar në vitet e 1990-ta, mirëpo që kur është liruar nga AKM-ja në vitin 2006, kjo ndërmarrje ka mbetur joaktive. Si pjesa tjetër e NSH-ve, kjo ndërmarrje siguron të hyra vetëm nëpërmjet dhënies me qira të hapësirave të saj. *Mulliri, Modeli dhe Beci* janë privatizuar, mirëpo asnjëra prej këtyre ndërmarrjeve nuk janë aktive sot.⁶² Prandaj, edhe sikur të gjitha

⁵⁸ *Jatex* ka ekzistuar me emrin ‘*Napredak*’ nga 1947 deri në 1980. Pastaj prej 1980 deri në 1990 u bashkua me *Emin Durakun*, dhe njëhej si ‘*Industria e Bashkuar e Tekstit Emin Duraku*.’ Në vitin 1990 u nda nga *Emin Duraku* dhe që atëherë ka qenë e njohur si ‘*Jatex*’ (Intervista e IKS me Gazmend Tuzi, Drejtor i *Jatex*, 15 Qershor 2010).

⁵⁹ *Metaliku* përbëhet prej *Meatliku-Energjetika (Furnizues me Energji)*, *Metaliku-Gypat (Gypat e Mbëshjellur)*, *Metaliku-Teli-Kordi (Tela të Metalit)* dhe *Metaliku-Transport (Transport)*.

⁶⁰ *Deva* përbëhet prej *Deva-Gazë*, *Deva-Separacion*, *Deva-Transhped* dhe *Deva-Commerce*. Punëtorët në vitin 1990 është vetëm për *Deva-Gazë*.

⁶¹ *Ereniku* kishte pesë ndërmarrje shtesë që përfshinin *Ereniku Vixhinia* (Përpunim i Duhanit), *Industria Ereniku*, *Tregtia Ereniku*, *Ferma e Shpezëve Ereniku* dhe *Prodhimtaria e Parë Ereniku*. Këto dy të fundit janë privatizuar.

⁶² *Mulliri* kishte rreth 115 punëtorë në vitin 1990. Të tjerët kishin 156 dhe 550 punëtorë, respektivisht. Sot nuk kanë asnjë punëtor.

NSH-të të privatizohen nesër, privatizimi në vetvete nuk garanton domosdoshmërisht ‘kthesën e duhur’ drejt rritjes ekonomike.

Lënia pas dore e industrisë kosovare që nga vitet e 1980-ta si dhe gjymtimi i saj ekonomik nga ana e regjimit të Millosheviqit kanë kontribuar në fillimin e ngadalshëm të pasluftës të këtyre gjigantëve të fjetur. Toka dhe ndërtesat janë ndoshta asetet më të çmueshme të mbetura të këtyre ndërmarrjeve pasi që makineria e mbetur është bërë e papërdorshme. Përveç kësaj, shumë NSH ishin pjesë integrale të ndërmarrjeve më të mëdha të ish-Jugosllavisë, dhe ishin ndërtuar për tregje të caktuara para disa dekadash. Nëse pak nga këto ndërmarrje të dikurshme ende ekzistojnë nuk varen më nga Kosova për prodhimitari. Shumë tregje në ndërkohë janë zhdukur.

Shikuar nga këndvështrimi realist, ish-ndërmarrjet shoqërore të Kosovës vështirë se do t’i hapin përsëri mijëra vende të punës që kanë ekzistuar në vitin 1989.⁶³ Pas privatizimit do të nevojiten investime intensive për riparimin dhe revitalizimin e fabrikave. Hartimi i planeve të fuqishme afariste dhe identifikimi i tregjeve të reja do të jenë kyçe për rikthimin e ish-ndërmarrjeve shoqërore në rrugën drejt rritjes ekonomike. Amortizimi i aseteve që nuk janë vjedhur apo shitur, shkatërrimi gjatë luftës dhe humbja e shumicës së tregjeve, e kanë bërë shumë të vështirë rihapjen e këtyre ndërmarrjeve.

Nxitës i Rritjes? Sektori Privat i Gjakovës

Çarshia e Vjetër, zemra e sektorit tregtar dhe prodhues të Gjakovës, po rreh ngadalë. Shumë shitore që gjinden buzë rrugëve të saj me kalldrëm, janë të mbyllura. Në mesditë, mund të gjesh numra të telefonit të shënuar në një letër dhe të ngjitur në dyert e mbyllura të shitoreve. Shumë pak pronarë të shitoreve kanë numër të mjaftueshëm të konsumatorëve për t’i mbajtur shitoret e tyre të hapura tërë kohën. Pranë atyre shitoreve që janë të hapura, punëtorët janë të ulur jashtë shitoreve duke biseduar apo luajtur letra me fqinjët e tyre. Qarkullimi është shumë i dobët; ‘Me sinqeritet të madh mund të them se puna ka rënë për 50 përqind krahasuar me vitin 2010,’ një pronar i binzesit lokal ankohej.⁶⁴ Ata thonë se shkalla e lartë e papunësisë në Gjakovë, kriza globale

⁶³ Fjalim i Andy Bearpark, Zv. PSSP për Shtyllën e Katërt, Konferenca për Privatizim e organizuar nga Riinvest, Qershor 2002.

⁶⁴ Intervisë e IKS me Nafi Roka, pronar i dyqanit, Korrik 2010.

financiare, konkurrenca (e padrejtë), kamatat dhe tatimet e larta, përfshirë këtu edhe tarifatat doganore, janë sfida serioze për bizneset e tyre.

I dominuar nga bizneset e vogla familjare, shitoret me pakicë, kafenetë dhe ofruesit e shërbimeve bazike, sektori privat i Gjakovës mbetet i dobët. Ai përbën vetëm 5.5 përqind të të gjitha bizneseve të regjistruara në Kosovë (vetëm Mitrovica ka përqindje më të vogël me 4.7 përqind).⁶⁵ Sipas Zyres së Administratës Tatimore në Gjakovë, 88 deri në 93 përqind të bizneseve aktive janë biznese me pronar të vetëm; pesë deri në dhjetë përqind janë ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuara; dhe dy përqind të mbetur janë ndërmarrje të mëdha.⁶⁶ Si në çdo vend tjetër në Kosovë, më tepër se 90 përqind e sektorit përbëhet nga bizneset e vogla familjare që nuk mund të krijojnë rritje me vlerë të shtuar.⁶⁷ Vetëm 2 prej 53 bizneseve të studiuara në qendër të Gjakovës deklaruan që nuk kanë punësuar asnjë të afërm.⁶⁸

Sektori privat i Gjakovës, si në vendet tjera në Kosovë, dominohet nga ndërmarrjet e vogla që punësojnë 1-5 punëtorë në aktivitete me vlerë të vogël të shtuar siç është tregtia me shumicë ose pakicë, apo aktivitete shërbyese siç janë hotelet dhe restorantet. Shitoret me shumicë dhe pakicë përfaqësojnë 50.5 përqind të bizneseve të regjistruara (shi Tabelen 3). Sektorët tjerë përfshijnë hotelet dhe restorantet (10.2 përqind), prodhimtarinë (9.7 përqind), transportin dhe

Table 3. Sektorët e Gjakovës në 2010

Sektorët	Nr.	%
Shitje me shumicë & Pakicë	1820	50.5
Hotelet & Restorantet	369	10.2
Prodhim	350	9.7
Transport & Komunikim	279	7.8
Komuniteti tjetër	271	7.5
Ndërtim	152	4.2
Qiradhënia e patundshmërive	136	3.8
Shëndetësi dhe Punë	98	2.7
Agrikulturë, Pylltari	61	1.7
Edukim	38	1.1
Minierë	10	0.3
Ndërmjetësim Financiar	10	0.3
Administratë Publike	4	0.1
Peshkim	2	0.1
Energji Elektrike	0	0.0
Ekonomitë Familjare Private	0	0.0
Total	3600	100

⁶⁵ Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Mars 2010.

⁶⁶ Intervista e IKS me Lazer Ramaj, Drejtor i Administratës Tatimore në Gjakovë, 17 shtator 2010.

⁶⁷ Banka Botërore, *Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Politikat, Veprimet Strategjike*, Prill 2010, f. xi.

⁶⁸ IKS, 'Gjendja e Sektorit Privat' hulumtimi i 53 bizneseve në dy lagje ku gjenden shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

komunikacionin (7.8 përqind), ndërtimtarinë (4.2 përqind) dhe bujqësinë (1.7 përqind) në mes tjerash.⁶⁹ Dominimi i tregut nga ana e sektorit të tregtisë, të përbërë kryesisht nga shitoret e vogla, shoqëruar me prodhimtarinë e kufizuar, e ilustron më së miri sektorin e pazhvilluar privat në qytetin e Gjakovës. Për momentin, këto shitore të vogla kanë shumë pak shpresë për tu rritur.

Jashtë qendrës së qytetit, sektori privat i Gjakovës karakterizohet nga ish-ndërmarrjet shoqërore. Vetëm njëra prej 15 NSH-të e privatizuara dhe një nga dy ndërmarrjet me aksione të përbashkëta janë plotësisht funksionale. Të dyja ndërmarrjet merren me ndërtimtari. Njëra prej tyre është ndërmarrja me aksione të përbashkëta *Dukagjini* e liruuar nga administrimi i AKM-së në vitin 2006.⁷⁰

Me 109 punëtorë, *Dukagjini* është njëri prej punëdhënësve më të mëdhenj privat në Gjakovë sot. Është poashtu njëra prej dy ndërmarrjeve kryesore të ndërtimit. Meqë kërkesa për ndërtimtari është ende e lartë, ky biznes do të mund të rritet po të kishte qasje në kapital.

Ndërmarrja tjetër prijëse është fabrika për prodhimin e tjegullave IMN, e themeluar në viti 1922, e privatizuar në vitin 2006 me emrin e ri *NIKI-S*.⁷¹ Ndërmarrja aktualisht ka 279 punëtorë, rritje kjo krahasuar me numrin prej 204 punëtorëve që i kishte në vitin 1990.⁷² Sot *NIKI-S* është njëra prej ndërmarrjeve më të mëdha në komunën e Gjakovës. Prodhimi i tjegullave në këtë ndërmarrje pothuajse është trefishuar që nga viti 2006.⁷³ Rreth 98 përqind të produkteve të saj shiten në Kosovë dhe dy përqind në Shqipëri. Megjithë rritjen e prodhimtarisë, drejtori i kësaj ndërmarrje thotë që ata nuk mund t'i përmbushin kërkesat e tregut në Kosovës. Prandaj, *NIKI-S* ka potencial për rritje të mëtutjeshme, por përsëri qasja në kapital e pengon zgjerimin e kësaj ndërmarrje.

⁶⁹ Enti Statistikor i Kosovës (ESK), *Repertoari Statistikor i Ndërmarrjeve në Kosovë (2004-2008)*.

⁷⁰ *Dukagjini* u themelua në vitin 1952 si ndërmarrje për ndërtimtari në Gjakovë. Ai funksionoi si NSH deri në vitin 1992 kur kapitali i tij u transferua nga publik në privat sipas ligjeve të Markoviqit. Nga viti 2003 deri në vitin 2007 ishte i regjistruar si NSH në UNMIK dhe statusi i tij si ndërmarrje me aksione të përbashkëta u njoh në prill të vitit 2007 (Intervista e IKS me Shaban Deva, drejtor i *Dukagjini*, 12 Prill 2010).

⁷¹ Intervista e IKS me Skender Bajrami, pronar dhe drejtor i *NIKI-S*, 2 Tetor 2010.

⁷² Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Komuna e Gjakovës, 2010.

⁷³ Ndërmarrja shtoi prodhimin për 269 përqind në mes viteve 2006 dhe 2009 (Intervista e IKS me Skender Bajrami).

Problem i vazhdueshëm për ndërmarrjet me prodhimtari të madhe është qasja e kufizuar në kredi afatgjate me kamata të arsyeshme dhe me periudha pozitive.⁷⁴ Kamatat ndryshojnë në mes 12 dhe 14 përqind varësisht nga lloji i kredisë dhe periudha e afatit. Periudha mesatare e afatit të kapitalit punues, që shpeshherë përdoren për të blerë mallwra, është një deri në dy vite. Periudha e afatit për kredi për investime kapitale, që përdoren për investime në makineri dhe në asete fikse, është pesë deri në shtatë vite. Mesatarisht, klientëve iu ofrohet periudha pozitive prej gjashtë muajve që nuk është e mjaftueshme për industrinë prodhuese në rritje.

Bankat kanë politika konservative për shkak të rrezikut të lartë që klientët mos t'i shlyejnë kreditë e tyre në tregun e ri dhe të papjekur të Kosovës. Arsyet shtesë për konservatizëm janë mungesa e mundësive për zbatim dhe sundimo i dobët i ligjit.⁷⁵ Edhe ashtu, politikat strikte të huazimit të të hollave e vështirësojnë qasjen në kapital për ato ndërmarrje që synojnë të zgjerohen. Pa qasje në kapital për investime dhe rritje, këto biznese prodhuese e kanë vështirë të bëhen motor i rritjes ekonomike.

Derisa sektori i prodhimtarisë dhe ai i tregtisë vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi, sektori i bujqësisë mund të jetë potencial për vendosjen e Gjakovës në rrugë drejt rritjes ekonomike. E vendosur në Rrafshin e Dukagjinit, Gjakova ka kushte të përshtatshme klimatike, tokë të pjellshme, sistem të ujitjes⁷⁶ dhe bujq me përvojë të duhur. Gjakova njihet për vreshtat e saj, të rrethuara nga lumenjtë Ereniku, Drini i Bardhë, Llukaci dhe Krena.

Deri në fillim të viteve 1990, bujqësia e shkallës së madhe në Gjakovë është organizuar në një numër të NSH-ve bujqësore. Këto kombinat bujqësore punonin në përpunimin e ushqimit, rritjen e bagëtisë dhe në bujqësi. Ato poashtu udhëhiqnin përpunimin e produkteve të ushqimit me djathore, thertore, ftohës, përpunim të drurit, tregti me pakicë, tregti me shumicë, punishte të verës, prodhimin e lëngjeve të frutave dhe me fabrikën e përpunimit të duhanit.

⁷⁴ Hulumtimi i IKS i pesë bankave kryesore (Maj-Qershor, 2010), përfshirë këtu *Banka Kombëtare Tregtare*, Raiffeisen Bank, NLB Prishtina, TEB, dhe ProCredit. *Banka Ekonomike* nuk ishte në dispozicion.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ Ujësjellësi *Radoniqi*, në Komunën e Gjakovës, ofron ujë për pije dhe për ujitje. Sistemi furnizon edhe komunat e Rahovecit dhe Prizrenit. Rreth 8,070 ha ujiten me pompa të rënies së lirë (IKS email komunikimi me Drejtorinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, 4 Tetor 2010).

Në mesin e agro-kombinateve më të njohura ishte *Ereniku*, i themeluar në vitin 1961.⁷⁷

Ereniku përfshinte disa kooperative bujqësore dhe merrej me përpunimin e duhanit, përpunimin e produkteve bujqësore, tregti me

shumicë dhe me prodhimin e frutave primare. Në vitet 1985-1986, *Ereniku* eksportonte lëngje natyrale, koncentrate dhe produkte të ngjashme në Kanadë, Gjermani, Austri, Rusi dhe Itali.⁷⁸ Sipas një punëtori të dikurshëm, *Ereniku* ‘konsiderohej njëri ndër kombinatet më të suksesshme në Kosovë dhe me gjasë edhe në rajon.’⁷⁹ Gjatë viteve të 1980-ta, *Ereniku* kishte teknologji moderne dhe lëndën e parë të vetën, e cila përpunohej, prodhohej dhe ambalazhohej në Gjakovë. *Ereniku* kishte përafërsisht 1,800 punëtorë në pesë sektorë.

‘Njëra prej kombinateve më të suksesshme bujqësore në Kosovë e ndoshta edhe në rajon.’

Sot, si shumica e NSH-ve në Gjakovë, statusi i *Erenikut* mbetet i paqartë. Drejtori i përgjithshëm i ndërmarrjes pohon që ky gjigant i dikurshëm është transformuar në një ndërmarrje me aksione të përbashkëta gjatë viteve 1990, por akoma mbetet nën juridiksionin e AKP-së.⁸⁰ Meqë nuk mund të regjistrohet si biznes apo financim me qasje, aktivitetet e ndërmarrjes janë reduktuar në dhënie me qira të hapësirave dhe tokës. Momentalisht ndërmarrja ka rreth 150-200 të punësuar, por ata nuk prodhojnë asgjë.

Në tërësi, sektori i përpunimit të produkteve ushqimore ka shënuar rënie të thellë që nga vitet 1980. Gjatë 20 viteve, sektori ka pësuar rënie në furnizim dhe prodhimtari të ulët. Janë humbur tregjet tradicionale të eksportit, kanalet vendore të marketingut janë ndërprerë dhe janë zvogëluar subvencionet qeveritare për plehra dhe ujitje. Tregtia bujqësore ka shënuar rënie drastike pasi që bujqit nuk mund të konkurrojnë në tregje rajonale pa kanale efektive vendore të furnizimit dhe pa subvencione të pamjaftueshme qeveritare. Sot, vetëm 1.7 përqind të bizneseve të regjistruara në Gjakovë (61 biznese) janë të

⁷⁷ *Ereniku* kishte pesë ndërmarrje shtesë: *Ereniku Vixhinia* (Përpunimi i Duhanit), *Industria Ereniku*, *Tregtia Ereniku*, *Ferma e Shpezëve Ereniku* dhe *Prodhimtaria Primare Ereniku*, prej të cilave dy të fundit janë privatizuar.

⁷⁸ Intervista e IKS me Fehmi Nallbani, drejtor i përgjithshëm në *Ereniku*, 7 Maj 2010.

⁷⁹ Intervista e IKS me Shkodran Gaxherri, menaxher i projekteve në Qendrën Zhvillimore të Kosovës dhe punëtor i dikurshëm në *Ereniku* (Prodhimtaria Primare), 10 janar 2011

⁸⁰ Intervista e IKS me Fehmi Nallbani, drejtor i përgjithshëm në *Ereniku*, 7 maj 2010.

sektorit bujqësor.⁸¹ Bujqit e rrallë që janë të orientuar kah tregtia nuk kanë qasje në kredi, tokë, kontribute cilësore dhe tregje me vlerë të lartë. Derisa institucionet mikrofinanciare iu ofrojnë kredi bujqve, këto kredi janë të vogla dhe afatshkurte. Për më tepër, kamatat prej 22-24 përqind janë mjaft të larta.⁸²

Shumica e kombinateve bujqësore kolektive dhe shoqërorë kanë kolapsuar dhe janë zëvendësuar nga fermat e vogla private që operojnë në nivelin e subvencioneve dhe gjysmë-subvencioneve. Ferma mesatare familjare ka vetëm 1.5 hektarë dhe është e ndarë në tetë parcela.⁸³ Një copë toke kaq e vogël ndoshta mund ta ushqej një familje, por produktet e tyre rrallëherë dalin në treg. Edhe në rastet kur shiten këto produkte, ato rrallëherë sjellin ndonjë fitim. Copëzimi i madh e ka penguar efikasitetin dhe prodhimtarinë eventuale në copa më të mëdha të tokës.

Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë i USAID-it (KPEP) është orvatur ta trajtoj këtë çështje duke e përkrahur formimin e kooperativave në Gjakovë.⁸⁴ Duke e kombinuar tokën, teknologjitë, teknikat dhe njohuritë, bujqit mund ta rrisin prodhimtarinë e tyre dhe të garojnë në treg. Për më tepër, kooperativat e rrisin qasjen e bujqve në tregjet e reja. Për shembull, kooperativat mund të ofrojnë fatura të Tatimit në Vlerë të Shtuar (TVSH) tek supermarketet ku bujqit individual nuk mund ta bëjnë këtë. Megjithatë, disa bujq u shprehën skeptik për kooperativat, dhe nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për t'i bindur ata rreth dobisë së kooperativave.⁸⁵

Në mesin e pak kooperativave ekzistuese është Qendra Bujqësore në Gjakovë. E privatizuar në vitin 2006, kjo qendër sot ka vetëm pesë punëtorë.⁸⁶ *Qendra Bujqësore* ka nënshkruar kontrata me 1,000 bujq të cilët sjellin produkte të përpunuara siç është qumështi dhe gruri. Në shkëmbim, ata marrin produkte të përpunuara apo të holla. Pikat e mbledhjes gjenden në dalje të qytetit të

⁸¹ ESK, *Repertoari Statistikor i Ndërmarrjeve në Kosovë (2004-2008)*.

⁸² Intervista e IKS me Edona Kryeziu-Xhambazi, u.d. Drejtoreshë e Shoqatës së Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës, 24 maj 2010.

⁸³ Banka Botërore, 'Shënim i Përkohshëm Strategjik 2009 për Vitet Financiare 2010, 2011.'

⁸⁴ Intervista e IKS me John MacKillop, Drejtor i Konkurrencës/Sektorit i Bujqësisë, USAID KPEP, 27 Maj 2010.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ Intervista e IKS me Pal Gjuraj, pronar i Qendrës Bujqësore dhe kryesues i Shoqatës për Zhvillimin Rural të Dukagjinit, 25 Shtator 2010.

Gjakovës. Kjo afërsi iu konvenon bujqve të cilët nuk duhet më të udhëtojnë në Xërxe ku gjendet kooperativa tjetër e madhe. *Qendra Bujqësore* poashtu ofron plehra dhe iu jep bujqve makineri me qira. Prandaj, bujqit jo vetëm që kanë treg të garantuar për produktet e tyre por kanë edhe qasje në teknologjitë të cilat nuk do të mund t'i blinin vet.

Një ndërmarrje tjetër e njohur është fabrika për përpunimin e qumështit *Golaj*. E themeluar si biznes familjar në vitin 1998, fabrika ka rritur fuqinë e saj punëtore prej gjashtë në dymbëdhjetë punëtorë. *Golaj* merr rreth 4,000 litra qumësht në ditë, duke u furnizuar kryesisht nga katër ferma të mëdha dhe 60-70 ferma më të vogla. Fabrika prodhon rreth 1,500 litra jogurt, 1,000 litra kos⁸⁷ dhe 700 litra qumësht të përpunuar në ditë. Të gjitha këto shiten në tregun kosovar. Megjithatë, pronari pohon që fabrika nuk ka pasur kapacitet ta përpunojë tërë qumështin që e ka marrë gjatë stinës së verës. Kostot e larta të ambalazhimit dhe fitimi i ulët i kanë pamundësuar edhe më tepër investimet në teknologji të re dhe në zgjerimin e fabrikës.

Bujqit dhe disa përpunues të produkteve ushqimore janë në disavantazh nga importet bujqësore nga partnerët tregtar të Kosovës të cilët përfitojnë nga subvencionet për prodhimtari dhe eksport dhe si rezultat futen në tregun e Kosovës me produkte më cilësore dhe më të lira.⁸⁸ Një fermere shpreh frustrimin e saj:

Përderisa kemi burime natyrore, pse i kanë lënë anash investimet në bujqësi? Komuna dhe ndoshta qeveria qendrore [...] duhet të investojnë më tepër në bujqësi sepse ky është sektori kryesor në Kosovë. Është turp që 70 përqind e qumështit të konsumuar vjen nga prodhuesit e huaj!⁸⁹

Mosbalancimi tregtar i Kosovës është çështje kyçe. Dikur, eksportet e Gjakovës në SH.B.A, Kanadë dhe Evropë arrinin në rreth \$100 deri 120 milion në vit.⁹⁰ Dy pikat kufitare (*Qafa e Morinës* dhe *Qafa e Prushit*), e

⁸⁷ Kosi është produkt qumështor pak më i dendur se jogurti.

⁸⁸ Banka Botërore, *Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Politikat, Veprimet Strategjike*, prill 2010, f. 85.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ Komuna e Gjakovës, 'Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm për Komunën e Gjakovës, bazuar në Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit,' 2007, f. 33.

lidhin komunën e Gjakovës me portin e *Shëngjinit* në Detin Adriatik, si dhe me *Shkodrën* dhe me *Malësinë* e Shqipërisë. Malësorët nga Shqipëria tradicionalisht janë varur nga produktet që shiteshin në Gjakovë, meqë qytetet më të afërta të Shqipërisë ishin shumë larg prej tyre. Qeveria e Kosovës mund t’iu ndihmoj qytetarëve të futen në tregje të ndryshme duke krijuar një mjedis të favorshëm, duke i ulur tarifatat doganore dhe duke i ofruar bujqve subvencione.

Mekanizmi vendor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rural është Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.⁹¹ Drejtorati ka themeluar Grupet Lokale të Veprimit të BE-së (GLV-të) si pjesë e Kornizës së Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së.⁹² GLV-ja në Gjakovë është themeluar si OJQ dhe përfshin ndërmarrje publike, private dhe zyrtarë komunal.⁹³ GLV-ja ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Lokal mbështetur në çështjet që i ka identifikuar në komunë. Dokumenti strategjik e njeh bujqësinë si sektor potencial për rritjen ekonomike të Gjakovës.

Sidoqoftë, banorët rural i kanë adresuar idetë e tyre zhvillimore drejtpërdrejt tek Drejtorati, e jo tek GLV-ja. Përveç kësaj, qytetarët është dashur t’iu drejtohen autoriteteve komunale në vend se këto të fundit të zhvillojnë konsultime aktive me qytetarët. Pjesërisht për shkak të dështimit për të siguruar pronësi lokale, GLV-ja ka hasur në vështirësi gjatë zbatimit të aktiviteteve të parapara në Strategji.⁹⁴ Përveç kësaj, GLV-ja nuk ka buxhet; ajo duhet të paraqes ide për projekte dhe të kërkojë fonde nga qeveria dhe donatorët. Përfshirja e banorëve të viseve rurale si pjesëmarrës aktiv në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e suksesit të këtyre politikave zhvillimore është shumë e rëndësishme për ta shtuar pronësinë dhe për të arritur zhvillim.

⁹¹ Buxheti i vogël i Drejtoratit është projektuar të rritet prej €320,718 në 2011 në €708,500 në 2013. Kjo rritje është domethënëse në aspekt të investimeve kapitale (nga €160,000 në 2011 në €505,000 në 2013).

⁹² Projekti Strategjia për Zhvillim Lokal financohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

⁹³ Biseda telefonike e IKS me Jeton Dedajn, Sekretar dhe Zv. President i Komitetit Ekzekutiv të GLV-së, 17 nëntor 2010. Anëtarët u trajnuan nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në hartimin e projekteve dhe aplikimit për grante (Intervista e IKS me Iva Stamenova, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, Udhëheqëse e Ekipit, Burimet Natyrore dhe Mjedisi, 3 qershor 2010).

⁹⁴ Biseda telefonike e IKS me Jahja Kadrija, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të GLV-së, 18 Nëntor 2010.

Aktivitetet e strategjisë që janë zhvilluar deri më sot janë financuar nga Komuna dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Për shembull, në fshatrat Rracaj dhe Sheremet janë ngritur dy penda dhe kanale të ujitjes me synim të rritjes së prodhimit të ushqimit.⁹⁵ Drejtorati po ashtu ka bërë monitorimin e të korrurave të vjeshtës, iu ka dhënë subvencione bujqve, i ka monitoruar kanalet e ujitjes, ka mbledhur ndihma humanitare, ka organizuar trajnime për bujq si dhe ka organizuar panaire. Drejtorati poashtu ju ka ofruar bujqve subvencione prej €200 për lopë për 99 kokë të importuara nga Zvicra. Gjashtë nga 33 përfituesit janë gra udhëheqëse të ekonomive të tyre familjare.⁹⁶ Komuna poashtu iu ka shpërndarë fermerëve plehra.

Përveç qeverisë komunale, OJQ-ja e grave *Medica Kosova (mK)* ka përkrahur rreth 380-400 femra që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare, shumica prej tyre fermere, që nga viti 1999.⁹⁷ Në vitin 2006, gratë në fshatin Korenicë morrën si donacion 16 lopë nga *mK*. Gratë i kanë falur viçat e parë femra tek gratë tjera. Me përkrahjen e USAID-it, ato kanë krijuar dy pika të mbledhjes së qumështit në fshatrat Korenicë dhe Krelan. Qumështi pastaj iu shitet dy kompanive private.⁹⁸ Me 15,000 metra katrorë tokë të falura nga komuna, *mK* është në proces të ndërtimit të fabrikës për përpunimin e qumështit.⁹⁹ Fabrika parashihet të punësoj rreth 120 fermere, por në fillim do t'i ketë 15. *mK* poashtu do t'i hap dy shitore ku gratë do të shesin produkte të qumështit dhe të mjaltit.¹⁰⁰ Kjo përkrahje financiare së bashku me atë profesionale psikologjike iu ka ndihmuar grave t'i mbajnë familjet e tyre dhe të ndërmarrin hapa drejt hapjes së agrobizneseve.

Një iniciativë tjetër pozitive ka qenë Projekti për Qeverisje Lokale i BE-së (EULoG), i cili ka përkrahur Drejtorinë Komunale për Zhvillim Ekonomik

⁹⁵ *Gjakova Press*, 'Në fshatrat e Gjakovës ndërtohen dy penda dhe kanale të ujitjes,' No. 27, gusht-shtator 2010, f. 24.

⁹⁶ Shoqata për Zhvillim Rural të Dukagjinit zbatoi projektin (Intervista e IKS me Pal Gjuraj, Kryesues, 25 Shtator 2010).

⁹⁷ Intervista e IKS me Veporë Shehu, Drejtore Ekzekutive e *medica Kosova*, 16 mars 2010.

⁹⁸ Intervista e IKS me Hatixhe Binaku, udhëheqëse e ekonomisë familjare, Korenicë, 15 mars 2010.

⁹⁹ Ky është projekt 3-vjeçar i përkrahur nga Ministria Federale për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik në Gjermani.

¹⁰⁰ Intervista e IKS me Veporë Shehu, Drejtore Ekzekutive e *mK*, 16 mars 2010.

dhe Këshillin për Zhvillim Strategjik.¹⁰¹ Këto dy subjekte janë përgjegjëse për lehtësimin e afarizmit dhe krijimit të mundësive për investime. Departamenti kryesisht është përqendruar në investimet kapitale në infrastrukturë. EULOg ka përkrahur hartimin e 147 projekteve bazuar në LDS; pesë prej tyre janë zgjedhur për t'iu dërguar Zyres Ndërlidhëse të Komisionit Evropian për financim IPA.¹⁰² Këto projekte do t'i dërgohen edhe Zyres për Investime në Zvicër. Komuna e Gjakovës e hapi këtë zyre më 28 tetor të vitit 2010 për ta tërhequr diasporën dhe investimet direkte të huaja. Investitorët tashmë kanë shfaqur interesim, posaçërisht në përpunimin e produkteve bujqësore.¹⁰³ IPA fondet, remitencat nga diaspora dhe investimet direkte të huaja mund të jenë burimet kryesore në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Gjakovë.

Komuna mund të ndërmarrë hapa për ta lehtësuar rritjen ekonomike në Gjakovë. Fermerët dhe pronarët e bizneseve vazhdimisht e kanë përmendur çështjen e procedurave të gjata dhe të shtrenjta të aplikimit, kërkesat dhe dokumentacionin e gjatë për fillimin dhe regjistrimin e bizneseve. Për ta filluar një biznes nevojiten deri në 52 ditë dhe nëntë procedura të ndryshme.¹⁰⁴ Marrja e licencës nga komuna merr 30 ditë dhe inspektimi i obligueshëm nga komisioni teknik komunal kushton €575. Komuna mund ta lehtësojë rritjen ekonomike duke i thjeshtuar procedurat dhe duke garantuar që stafi të jetë më efikas në kompletimin e procedurave të aplikimit për lejet e ndryshme afariste. 'One Stop Shop' e financuar nga Banka Botërore, në përputhje me PVPE-në, mund të jetë hap pozitiv në këtë drejtim.¹⁰⁵

Një çështje tjetër të cilën pronarët e bizneseve e përmendin shpesh është mungesa e qasjes në kredi, gjë që ka pamundësuar investimet në teknologji të re dhe në rritje. Duke marrë parasysh se një e tillë nuk ekziston, themelimi i një banke bujqësore me shtrirje kombëtare mund t'iu jap fermerëve qasje në kredi afatgjate. Në përgjithësi, kreditë afatgjatë me kamata të arsyeshme dhe periodha pozitive mund ta lehtësojnë rritjen e sektorit privat. Komuna poashtu

¹⁰¹ EULOg është projekt i financuar nga BE-ja që synon të përmirësojë performancën dhe llogaridhënien komunale; të hartoj plane zhvillimore komunale; të rris shërbimet inspektuese të komunës; dhe të inkurajoj bashkëpunimin ndërkomunal (Intervista e IKS me Zet Çelaj, ekspert vendor, EULOg, 15 Qershor 2010).

¹⁰² IPA ofron asistencë për vendet që janë në procesin e përafrimit me BE-në nga 2007 deri më 2013.

¹⁰³ Biseda telefonike e IKS me Lan Avdija, koordinator i Zyres për Investime në Gjakovë, në Zurich, 12 Nëntor 2010. Themelimin e zyrës e ka përkrahur Diaspora Shqiptare në Zvicër.

¹⁰⁴ Banka Botërore, *Të Bërit Biznes*, 2010, f. 54.

¹⁰⁵ Prioritet i PVPE 55.11.

mund të punojë më tepër në trajtimin e konkurrencës së padrejtë duke u marr me ekonominë joformale dhe me evazionin fiskal, siç parashihet në PVPE.¹⁰⁶ Komuna duhet të bashkëpunojë me donatorët për t'i inkurajuar kooperativat. Duke kombinuar tokën, teknologjitë, teknikat dhe njohuritë, fermerët mund ta rrisin të ardhurat e tyre.

Për më tepër, Komuna mund t'i bashkërendojë investimet e BE-së në zhvillimin e mëtutjeshëm të tregtisë tejkuftare me fokus të veçantë në prodhimtarinë bujqësore dhe atë të ushqimit. Në këtë drejtim, subvencionet për fermerët e Kosovës dhe negociimi i marrëveshjeve për doganën dhe tarifën mund ta përmirësojë tregtinë në mes Shqipërisë dhe Kosovës. Hulumtimi i tregut mund t'i ndihmojë Gjakovës të identifikojë tregjet tjera potenciale. Shoqatat e fermerëve po ashtu mund të bëjnë më tepër në promovimin e produkteve të tyre tek konsumatorët kosovar.

Në fund, qeveria qendrore dhe ato komunale mund të bashkëpunojnë me BE-në për ta zgjidhur procesin e ngecur të privatizimit dhe ta shtyjnë atë përpara, në përputhje me PVPE-në. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme duhet të vendosë urgjentisht mbi rastet e privatizimit. Pastaj, investimet, planet e fuqishme afariste si dhe sigurimi i tregjeve të reja do të jenë kyçe për kthimin e ish-ndërmarrjeve shoqërore kah rritja ekonomike. Ndërhyrjet e lartpërmendura të politikave mund ta kthejnë Gjakovën në udhë drejt rritjes ekonomike përbrenda kornizës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

¹⁰⁶ Prioritet i PVPE 57.5.

II. DREJT ZHVILLIMIT NJERËZOR

Derisa kapitulli i fundit përqendrohet në arritjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike, ky kapitull shqyrton në shkallë më të gjerë se cilat politika do të mund të krijojnë një mjedis i cili do të mundësonte zhvillim të mëtutjeshëm njerëzor duke e përdorur kornizën e bazuar në të drejtat e njeriut, në përputhje me politikën zhvillimore të BE-së dhe me standardet e anëtarësimit. Zhvillimi njerëzorë mund të konceptohet si përmirësim i aftësive njerëzore: çka është në gjendje një person të bëjë dhe të jetë, përfshirë këtu mundësitë dhe lirinë e zgjedhjes.¹⁰⁷ Një qasje pjesëmarrëse është kyçe për të siguruar që njerëzit mund të luajnë rol aktiv në identifikimin e prioriteteve të tyre.¹⁰⁸

Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë po ashtu trajton pjesëmarrjen qytetare si proces kyç. Ligji parasheh krijimin e mekanizmave siç janë komisionet këshilldhënëse për ‘të mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.’¹⁰⁹ **Përveç kësaj, statuti i komunës së Gjakovës parasheh teknika me anë të të cilave komuna mund të konsultohet me qytetarë dhe ta shtoj pjesëmarrjen publike në proceset vendimmarrëse.**¹¹⁰

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, anëtarët e zgjedhur të Kuvendit Komunal duhet t’i promovojnë programet dhe aktivitetet e kuvendit, të diskutojnë politikën me grupet e interesit dhe ta ftojnë publikun në rishikimin e politikave dhe draft rregulloreve. Ata poashtu duhet të takohen së paku dy herë në vit me publikun.

Kryetari i komunës së Gjakovës, Dr. Pal Lekaj, thotë se ai ka marrëdhënie të ngushta dhe rezervon një ditë në javë ‘për vizita me qytetarë.’ Megjithatë mbetet e paqartë shkalla në të cilën dispozitat e komunës për pjesëmarrje dhe përpjekjet e kryetarit të komunës kanë rezultuar me pjesëmarrje aktive qytetare apo në ndryshime të politikave sipas kërkesave të qytetarëve.

¹⁰⁷ Sen, 1999.

¹⁰⁸ Sen, 1999. Shih edhe, Komuna e Gjakovës, ‘Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës, 2007-2015,’ f. 13.

¹⁰⁹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, Neni 73.1 thotë: ‘Kuvendi Komunal do të themeloj komisione konsultative brenda sektorëve për ta mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse (shih: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,249>).

¹¹⁰ Statuti i Komunës së Gjakovës, 2004.

Qytetarët pohojnë që zyrtarët komunal nuk i përcjellin temat e diskutuara dhe nuk ndërmarrin veprime bazuar në brengat e shprehura nga qytetarët.¹¹²

Përveç kësaj, gjatë planifikimit të buxhetit, që bëhet nga drejtoritë komunale dhe miratohet nga kuvendi komunal, nuk ka mekanizma nëpërmjet të cilëve qytetarët do të mund të kontribuonin në priorizimin e çështjeve për financim.¹¹³ Kjo ka implikime të rëndësishme në atë se cilët sektorë marrin mbështetje (siç ilustron Tabela 4), për shkallën në të cilën Kuvendi Komunal plotëson nevojat e qytetarëve dhe shkallën në të cilën detyrimet në përputhje me anëtarësimin në BE janë plotësuar.

Politikat në nivelin komunal janë të rëndësishme për trajtimin e aspekteve të ndjeshme në drejtim të zhvillimit njerëzor të bazuar në zonë. Janë krijuar disa mekanizma, të cilët në teori do të duhej të siguronin mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët. Në fakt, në pajtim me PVPE-në, komuna e Gjakovës në vitin 2008 ka themeluar Njësinë për të Drejtat e Njeriut, për promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë, si dhe për monitorimin e zbatimit të ‘Strategjisë së Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut.’¹¹⁴ Njësia ka tre zyrtarë të cilët janë përgjegjës për të monitoruar nëse qytetarët e Gjakovës

Tabela 4.
Plani Buxhetor i Gjakovës për vitin 2011¹¹¹

Organizimi Buxhetor	Shuma	%
Edukim dhe Shkencë	6,186,156	39.2
Buxheti & Financat	2,728,690	17.3
Shëndetësi & Mirëqenie Sociale	2,037,001	12.9
Zhvillimi Ekonomik	1,160,500	7.4
Shërbimet Publike	1,154,800	7.3
Administrata	703,000	4.5
Kulturë, Rini, Sport	347,859	2.2
Agrikulturë	320,718	2.0
Mbrojtje Civile & Shpëtim	314,560	2.0
Zyra e Kryetarit	165,000	1.0
Kadastër, Gjeodezi, Pronë	157,500	1.0
Planifikimi Urban & Mbrojtja e Mjedisit	155,000	1.0
Zyra e Asamblesë Komunale	113,500	0.7
Inspezioni	109,200	0.7
Performanca në Shëndetësi	76,110	0.5
Zyra për Komunitete dhe Kthim	24,200	0.2
Prokurimi	21,900	0.1
Total	15,775,694	100

¹¹¹ Compiled based on Gjakova Municipality, ‘Municipal Budget of Gjakova 2011-2013,’ September 2010.

¹¹² Intervistat e IKS me Ekipin Ndërkombëtar Monitorues të Kuvendit Komunal të Gjakovës, 11 tetor 2010 dhe Arbnor Pula, ish Drejtor Ekzekutive i Forumit për Iniciativa Demokratike (FID), 25 Shtator 2010.

¹¹³ Intervistat e IKS me Zyrtarë Komunal dhe me qytetarë.

¹¹⁴ PVPE, prioritet 9.2.

kanë qasje në të drejta të barabarta dhe të raportojnë tek Zyra për të Drejtat e Njeriut në Zyren e Kryeministrit.

Megjithatë, Njësia ka hasur në vështirësi në përmbushjen e mandatit të saj. Zyrtarët e Njesisë kanë deri në katër emërime të ndryshme si shërbyes civil në të njëjtën kohë, gjoja për shkak të fondeve të pamjaftueshme.¹¹⁵ Duke kryer disa funksione, disa teknikisht mbi të tjerat, do të thotë që këta zyrtarë janë të stërngarkuar me punë dhe përgjegjësi.

Përveç kësaj nuk ka një strategji komunale e cila do të shërbente si udhërrëfyes për Njësinë. Në raportin e vitit 2010 shihet që derisa Njësia nuk angazhohet në mënyrë aktive në monitorimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (apo të ndonjë ligji tjetër).¹¹⁶ Plani i punës për vitin 2011 parasheh fushata të vetëdijësimit dhe tryeza të rrumbullakëta, por nuk përmend asnjë aktivitet për monitorimin e zbatimit të ligjive apo të shkeljes së drejtave të njeriut, që është në mandatin e Njesisë. Aty përmendet monitorimi i integritetit të komuniteteve por nuk propozohet asnjë aktivitet apo indikator. Në raport mungojnë indikatorët e qartë për të matur nëse Njësia i ka përmbushur objektivat e saj. Është kyç të respektohet dhe zbatohet ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, jo vetëm pse është kyç për anëtarësim në BE por edhe pse është tejet i rëndësishëm për zhvillimin njerëzor.

Dëshmitë tregojnë që për shkak të marrëdhënieve shoqërore dhe politikave diskriminuese brenda shoqërisë, disa qytetarë në veçanti nuk gëzojnë mundësi të barabarta. Mundësitë e pabarabarta, përjashtimi shoqëror (p.sh. në qasjen në arsim, punësim, shëndetësi), lokacioni gjeografik, dhuna gjinore, pabarazitë etnike, hierarkia moshore dhe pabarazitë ekonomike, të gjitha mund të pengojnë pjesëmarrjen në vendimmarrje.¹¹⁷ Si në çdo vend tjetër në botë, grupet me më së paku përfaqësim janë grupet më të ndjeshme. Në Gjakovë,

¹¹⁵ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku, zyrtare për Barazi Gjinore dhe Koordinatorë e Njesisë për të Drejtat e Njeriut, Gjakovë, 24 shkurt 2011.

¹¹⁶ Komuna e Gjakovës, 'Raporti i Njesisë për të Drejtat e Njeriut për Zbatimin e Strategjisë së Planit Veprimor për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Gjakovës 2010,' drejtuar Zyrtarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Kryeministrit.

¹¹⁷ Shih Ariana Qosaj-Mustafa për Institutin Kosovar për Kërkime dhe Hulumtime të Politikave (KIPRED), 'Forcimi i Qytetarisë së Gruas në Kontekstin e Shtetdërtimit: Sektori i Sigurisë në Kosovë dhe Decentralizimi,' Prishtinë: KIPRED dhe FRIDE, korrik 2010 dhe Rrjeti Kosovar i Gruas (KËN), *Siguria Fillon në Shtëpi: Hulumtime për ta Informuar Strategjinë e Parë Kombëtare dhe Planin Veprimor kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: KËN, 2008.

këto janë femrat, të rinjtë dhe pakicat, në veçanti romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit.¹¹⁸ Në përputhje me politikën zhvillimore të BE-së, PVPE-ja e trajton si prioritet integrimin shoqëror të këtyre grupeve të ndjeshme.¹¹⁹ Duke marrë parasysh gjendjen e tyre të ndjeshme si dhe PVPE-në, ata janë në fokus të këtij kapitulli. Kapitulli në përfundim jep rekomandime të politikave drejt zhvillimit njerëzor në rrugë drejt anëtarësimit në BE.

Të Rinjtë: Forcë Shtytëse apo Forcë në Largim e Sipër?

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve përafron legjislacionin kombëtar me ligjin e BE-së, me synim të përfshirjes dhe zhvillimit të rinisë.¹²⁰ Në përputhje me këtë Ligj, në vitin 2001 qyteti i Gjakovës ka themeluar Departamentin e Kulturës, Rinisë dhe Sportës si dhe ka caktuar Zyrtarin për Rini.¹²¹ Përveç kësaj, rrjeti lokal i rinisë, i themeluar në vitin 2003 si organizatë ombrellë për të gjitha OJQ-të rinore, u transformua në Këshillin e Veprimit Rinor Lokal të Gjakovës në vitin 2008. Sipas ligjit, këshillat rinor duhet t'i përfaqësojnë nevojat e të rinjve në nivelin komunal dhe t'i këshillojnë institucionet qendrore. Këshilli Lokal i Veprimit Rinor i Gjakovës, i cili përfaqëson 31 OJQ rinore, qendra dhe këshilla shkollor, u bë funksional në gusht të vitit 2010.¹²²

Siç është e paraparë me ligj, të rinjtë e hartuan Planin komunal për Veprim Rinor për vitet 2010-2012.¹²³ Ky dokument kyç synon ta përmirësojë gjendjen e të rinjve duke i përfshirë ata, si dhe institucionet qeveritare dhe joqeveritare

¹¹⁸ Qendra Informuese dhe Kulturore e BE-së, 'Europa A në Z: Promovimi i të Drejtave të Njeriut,' at http://euicc-ks.com/en/eu_and_kosovo/europa_a_to_z, qasur më 4 Mars 2011.

¹¹⁹ PVPE, prioritet 42.1.

¹²⁰ Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve, Nr. 03/L-145, 2009.

¹²¹ Intervista e IKS me Urim Fazlija, Zyrtar i Rinisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Gjakovës, 29 Tetor 2010.

¹²² Këshilli i Veprimit Rinor të Gjakovës u bë funksional në gusht të vitit 2010 nëpërmjet udhëzimit administrative të lëshuar nga Departamenti i Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në përputhje me Ligjin për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve.

¹²³ Plani i Veprimit Rinor ka gjashtë objektiva kryesore: 1) pjesëmarrjen e të rinjve; 2) arsimit joformal; 3) punësimi; 4) shëndeti; 5) siguria njerëzore; dhe 6) kultura, sporti dhe rekreacioni. Çdo objektive ka disa aktivitete. Qasjet janë: rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje; arsimimi i të rinjve në aftësi praktike, gjuhë të huaja dhe demokraci; informimi i të rinjve për mundësitë për punësim; arsimimi i të rinjve për shëndetin; parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore; promovimi i mbrojtjes së mjedisit; sigurimi i sigurisë ndëretnike; dhe përkrahja e veçantë për artistët e rinj, sportistët, të rinjtë në viset rurale dhe të rinjtë në diasporë (Komuna e Gjakovës, 'Plani i Veprimit Rinor 2010-2012,' Gjakovë, 2010).

në identifikimin dhe trajtimin e nevojave të të rinjve. Dokumenti po ashtu parasheh krijimin e mekanizmave për pjesëmarrjen e të rinjve në procese vendimmarrëse.

Megjithatë, Plani i Veprimit për Rini nuk ka indikatorë të qartë dhe as nuk specifikon institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij. Zbatimi i Planit do të varet në masë të madhe nga akordimi i fondeve të mjaftueshme nga ana e Komunës.

Përkundër këtyre mekanizmave institucional, duket se mundësitë e pakëta për shkollim si dhe shkalla e lartë e papunësisë (shkalla e regjistruar e papunësisë në Gjakovë është 54 përqind) po i detyrojnë të rinjtë e Gjakovës që të largohen nga qyteti i tyre.¹²⁴ ‘E vetmja mënyrë përpara është të shkosh në Prishtinë,’ thotë Korabi, një 24 vjeçar, i cili punon në një kafe-bar për t’i mbuluar shpenzimet e studimeve në Universitetin e Prishtinës. ‘Gjakova nuk ka universitet dhe nuk ofron vende të punës. Të qëndrosh në Gjakovë do të thotë të mos kesh shkollim të lartë dhe të jesh i papunë.’¹²⁵

‘Të qëndrosh në Gjakovë do të thotë të mos kesh shkollim të lartë dhe të jesh i papunë.’

Fidani, një 28-vjeçar i cili punon si kamarier, pajtohet, ‘Edhe pasi punova për tre muaj në Gjakovë nuk mund t’i mbuloja shpenzimet e mia personale, përderisa në Prishtinë me punën e njejtë mund ta paguaj qiranë, kam mjaft të holla për vete dhe po ashtu mund t’i ndihmoj familjes sime në Gjakovë.’ Edhe Agneta Bytyqi, njëra nga katër të rinjtë që u zgjodhën në Kuvendin Komunal të Gjakovës, kishte menduar të zhvendoset në Prishtinë:

Jam përpjekur shumë për të gjetur vend të punës në profesionin tim [ndërtimtari] në Gjakovë, por ishte e pamundur, ndërsa në Prishtinë kam marrë shumë oferta për punë dhe për intervistë. Nëse nuk gjej

¹²⁴ Rreth papunësisë, shih Banka Botërore, *Kosovë, Rinia në Rrezik: Të Jesh i Ri i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, Prishtinë: Banka Botërore, Shtator, 2008, f. iv. Prej 18,733 të regjistruarve si të papunë, 10,090 janë nën moshën 25 vjeçare (Qendra Rajonale për Punësim në Gjakovë). Nxënësit e shkollave të mesme identifikuan shkollimin e dobët dhe mundësitë e pamjaftueshme për punësim si arsytet kyçe për emigrim (IKS fokus grupi, Gjakovë, Prill 2010. Shih edhe IKS, *Zbërthimi i Ndryshimit: Zërat e Rinisë Kosovare 2010*, Prishtinë: UNICEF, Tetor 2010).

¹²⁵ Intervista e IKS me Korab Bakalli, student 24-vjeçar i ndërtimtarisë në Universitetin e Prishtinës, 19 Nëntor 2010.

vend të punës në Gjakovë, do të më duhet të zhvendosem në Prishtinë, edhe pse ndjej përgjegjësi ndaj qytetarëve të cilët ma kanë dhënë votën.

Në të vërtetë, Gjakova ka traditë të emigrimit. Gjakova ka ndër shifrat më të larta komunale të emigrimit: 11.5 nga 1000 banorë.¹²⁶

Për më tepër, të rinjtë që mbesin në Gjakovë nuk mendojnë që institucionet vendimmarrëse i marrin parasysh interesat e tyre.¹²⁷ Edhe ata të rinj që kanë qasje në autoritetet komunale, përfshirë këtu anëtarët e kuvendit komunal siç është Agneta, mendojnë që idetë e tyre shumë rrallë merren parasysh apo zbatohen.¹²⁸

Autoritetet komunale mund të bëjnë më tepër për t'i përfshirë të rinjtë si forcë shtytëse për zhvillimin e Gjakovës në mënyrë që ata të mos largohen nga ky qytet. Autoritetet komunale mund të fillojnë ta bëjnë këtë duke i përcjellur kërkesat e Këshillit për Veprim Rinor dhe anëtarët e rinj të kuvendit komunal.

Sigurimi i përkushtimeve të mjaftueshme financiare për Këshillin për Veprim Rinor të Gjakovës, qendrën rinore dhe planin janë shumë të rëndësishme për t'i adresuar nevojat e identifikuar zhvillimore të të rinjve. Qartëzimi i indikatorëve të Planit dhe sigurimi i zbatimit të tyre mund t'i fuqizoj të rinjtë dhe t'i shtoj mundësitë që ju tregohen atyre. Për ta ulur nivelin e papunësisë në mesin e të rinjve, the komuna mund të iniciojë programe që lidhin kërkesat e tregut të punës me prioritetet arsimore dhe mundësitë e praktikës për të rinjtë.¹²⁹

¹²⁶ ESK, *Anketa Demografike dhe e Shëndetit 2003*, Prishtinë: Shkurt 2004.

¹²⁷ Vetëm 5.5 përqind të të rinjve të grupmshës 15-24 vjeçare besojnë që institucionet vendimmarrëse i marrin shumë parasysh interesat dhe nevojat e të rinjve. Afro 32 përqind mendojnë që brengat e tyre merren parasysh deri 'në një shkallë', 28.3 përqind mendojnë që brengat e tyre merren shumë pak parasysh dhe 19.7 përqind mendojnë që nevojat e tyre fare nuk merren parasysh (IKS, *Çlirio Ndryshimin: Zërat e të Rinjve të Kosovës 2010*, f.55).

¹²⁸ Intervista e IKS me Agneta Bytyqi, anëtarë e kuvendit komunal të Gjakovës (LDK), 28 Korrik 2010.

¹²⁹ Shih IKS, *Çlirio Ndryshimin*, 2010.

Rrugë e drejt apo e tërthortë: Të Drejtat e Gruas dhe Barazia Gjinore

Diçka relevante në mënyrë specifike për Gjakovën e pasluftës është që BE-ja e njeh ‘lidhjen e ngushtë në mes çështjeve të paqes, sigurisë, zhvillimit dhe barazisë gjinore.’¹³⁰ Si pjesë e ‘qasjes së përgjithshme’ të BE-së:

Krahas nevojës për promovimin e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së gruas në situata të konfliktit dhe në ndërtim të paqes, po aq e rëndësishme është nevoja për të siguruar që këto veprime do të shoqërohen me vlerësime më të gjëra zhvillimore, siç është promovimi i sigurisë dhe mundësive ekonomike të gruas si dhe qasja e tyre në shërbime shëndetësore dhe arsim.¹³¹

Drejt zhvillimit dhe në përputhje me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gruan, Paqen dhe Sigurinë, BE-ja bën thirrje për përfshirjen e gruas në rindërtimin e Kosovës dhe për vëmendje ndaj nevojave të veçanta të gruas. Rezoluta 1325 i jep gruas të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe bën thirrje për caktimin e grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse.¹³²

Për më tepër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës konfirmon aplikueshmërinë e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (CEDAW).¹³³ Ligji për Barazi Gjinore, Programi Kosovar për Barazi Gjinore 2008-2013 dhe Ligji Kundër Diskriminimit, të gjithë përmbajnë dispozita për mundësitë e barabarta për femra dhe meshkuj në Kosovë. Kushtetuta dhe Ligji për Barazi Gjinore e sigurojnë ‘barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, ofrimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat e tjera të jetës shoqërore.’¹³⁴

¹³⁰ Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni GSC, ‘Qasja gjithpërfshirëse e BE-së në zbatimin e Rezolutave 1325 dhe 1820 të OKB-së për femrat, paqen dhe sigurinë’, Bruksel: 1 Dhjetor 2008. Në: http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/hr/news187.pdf, shikuar më 2 Mars 2011.

¹³¹ *Po aty*, p. 9.

¹³² Fatkeqësisht zbatim i Rezolutës 1325 të OKB-së është injoruar në masë të madhe si nga vendimmarrësit vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë (shih raportet monitoruese të KWN-së për zbatimin e Rezolutës 1325 të OKB-së në Kosovë, Prishtinë: KWN, 2007 dhe 2009, në www.womensnetwork.org.)

¹³³ Kushtetuta e Kosovës, Neni. 22.6.

¹³⁴ Kushtetuta e Kosovës, Neni 7.2, dhe Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 2004/2 për Barazinë Gjinore në Kosovë, Neni 1.2.

PVPE-ja përmban veprime prioritare për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe për promovimin e të drejtave të grave.¹³⁵ Ky seksion vlerëson se në çfarë shkalle Komuna e Gjakovës ka marrë rrugën e duhur apo atë të tërthortë për përmbushjen e këtyre obligimeve ligjore. Më pastaj diskuton se cilat ndryshime të politikave, nëse ka ndonjë, mund të krijojnë një mjedis i cili mundëson zhvillimin e mëtutjeshëm të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore, në rrugë drejt anëtarësimit në BE.

Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, PVPE-ja parasheh krijimin e Zyrave për Barazi Gjinore nëpër komuna.¹³⁶ Zyrtarët Komunal për Barazi Gjinore (ZBGJ) të emëruar në krye të këtyre zyreve janë përgjegjës për rritjen e përfshirjes së gruas në procese vendimmarrëse, si dhe për të siguruar që i tërë legjislacioni komunal t'i marr parasysh çështjet gjinore. ZBGJ komunal ka rol të rëndësishëm për të siguruar që zëri i femrave, posaçërisht atyre që janë të marginalizuara dhe të pambrojtura, të dëgjohej në proceset vendimmarrëse dhe që politikat e reja komunale t'i marrin parasysh nevojat e tyre specifike.¹³⁷

Megjithatë deri sot, ndërveprimet e vetme të ZBGJ-së me qytetarët e Gjakovës ishin kur ato vizitonin zyren e saj apo merrnin pjesë në tryeza të rumbullakëta. Janë bërë pak përpjekje për tu takuar me femrat e pambrojtura për t'i diskutuar nevojat e tyre apo politikat e reja. Zyra për Barazi Gjinore nuk ka bërë ndonjë analizë të nevojave prioritare e as nuk është konsultuar me grupet e synuara (p.sh. me qytetarët) gjatë hartimit të strategjisë vjetore. Në vend të kësaj, ZBGJ në konsultim me personat e tjerë brenda Njesisë për të Drejtat e Njeriut ka caktuar aktivitetet 'bazuar në përvojën e vitit të shkuar'. Në Plan nuk është përfshirë monitorimi i legjislacionit, dhe ZBGJ nuk ishte në gjendje të shpjegonte se si i monitoron apo raporton mbi zbatimin e politikave për barazi gjinore, që janë detyra kyçe sipas PVPE-së dhe Ligjit për Barazi Gjinore.¹³⁸ Përveç kësaj, Plani nuk ka shfrytëzuar menaxhmentin e bazuar në rezultate për të specifikuar rezultatet dhe aktivitetet që do të kontribuonin në mënyrë të qartë dhe strategjike në përmbushjen e objektivave kombëtare për

¹³⁵ PVPE, veprimet 39 dhe 116.

¹³⁶ PVPE, prioritet 39.5; Ligji për Barazi Gjinore, Neni 4.15.

¹³⁷ ZBGJ-të duhet 'të rishikojnë çdo vendim që e merr qeveria lokale, para miratimit' (Ligji për Barazi Gjinore, Neni 4.16).

¹³⁸ PVPE, prioritet 116.2.

barazi gjinore dhe për të drejtat e gruas.¹³⁹ Në vend të kësaj, aktivitetet ad-hoc si vetëdijësimi, tryezat e rumbullakëta dhe seminarët dukej se përsëritnin punën e OJQ-ve.

Mungesa e rezultateve të ZBGJ-ve anembanë Kosovës i është atribuar fondeve të pamjaftueshme, përkrahjes institucionale, vullnetit politik, ekspertizës teknike/profesionale në politikbërjen e ndjeshme ndaj çështjeve gjinore si dhe në qartësinë e mandatit të tyre.¹⁴⁰ Në fakt, ZBGJ në Gjakovë kishte ‘dy kapela’ (njërën mbi tjetrën), duke punuar në të njëjtën kohë si Kordinatorë e Njësisë për të Drejtat e Njeriut. Duket qartë se komuna nuk kishte fonde të mjaftueshme për të punësuar një person tjetër.¹⁴¹ Kryerja e dy funksioneve në mënyrë të suksesshme nuk duket aq e realizueshme. Për më tepër, Zyra për Barazi Gjinore nuk e ka buxhetin e saj vjetor, por duhet të kërkojë fonde për çdo projekt.¹⁴² ZBGJ-ja thotë që buxheti i pamjaftueshëm e ka pamundësuar zyren që ta zbatoj planin e saj të veprimit.¹⁴³

Sa i përket pjesëmarrjes së gruas në qeverisje komunale, kuota gjinore ka siguruar që femrat mbajnë 14 nga 41 ulëset (34 përqind).¹⁴⁴ Megjithatë, vetëm dy prej 13 drejtorive komunale udhëhiqen nga femrat. Në këtë drejtim, Komuna dhe kryetari i komunës konkretisht kanë dështuar ta zbatojnë Ligjin për Barazi Gjinore, i cili bën thirrje për emërimin e së paku 40 përqind femrave dhe 40 përqind meshkujve.¹⁴⁵

¹³⁹ Nuk ka ekzistuar asnjë indikator për matjen e suksesit. Plani vjetor i punës poashtu përfshin aktivitetet për Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Zyren për Barazi Gjinore (Komuna e Gjakovës, Njësia për të Drejtat e Njeriut, ‘Plani i Punës, Janar – Dhjetor 2011’).

¹⁴⁰ Shih KWN, *Monitorimi i Zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, edicioni i dytë, Prishtinë, 2009, f. 5 dhe KIPRED, pp. 26-27.

¹⁴¹ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku, Gjakovë, 24 Shkurt 2011.

¹⁴² Biseda telefonike e IKS me Lumnije Shllaku, 2 Mars 2011. Buxheti duhej të kërkohej nga Bordi i Drejtorëve i Drejtoratit për Administratë të Përgjithshme.

¹⁴³ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku, Gjakovë, 24 Shkurt 2011.

¹⁴⁴ Ligji No. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, 2008, Neni 7.2. Pastaj, Neni 3.2 i Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 2004/2 thotë që ‘pjesëmarrja e barabartë gjinore e femrave dhe meshkujve arrihet në raste kur pjesëmarrja e një gjinie të caktuar në institucione, trupa apo nivele të autoritetit është 40%.’

¹⁴⁵ Ligji për Barazi Gjinore Nr. 2004/2, Neni 3.2.

Për më tepër, vendimmarrja ende bëhet kryesisht në partitë politike të dominuara nga meshkujt; politikat dhe programet e partive politike rrallëherë

‘Unë e luftoj këtë betejë çdo ditë, brenda partisë dhe jashtë.’

marrin parasysh nevojat e ndryshme të meshkujve dhe femrave.¹⁴⁶ Anëtarët e asamblesë zakonisht kanë ndikim minimal në partitë e tyre politike e rrjedhimisht edhe në vendimmarrje. Mimoza Kusari-Lila, nënkryetare e AKR-së e lindur në Gjakovë, shpjegon se femrat përceptohen në mënyrë paragjyquese si tejet të dobëta për politikë.¹⁴⁷ Ajo poashtu thotë që udhëheqësit politik mundohen t’i manipulojnë femrat për ta çuar përpara agjendën e tyre: ‘Unë e luftoj këtë betejë çdo ditë, brenda dhe jashtë partisë.’ Respondentët thonë që anëtarët e parlamentit shfaqin tendenca për ta përcjell diktatin e udhëheqësve partiak dhe të prioritojnë punët e partisë, në vend se të promovojnë çështjet gjinore.¹⁴⁸ Sipas një anëtare të parlamentit, gjatë kohës së saj në zyre, në parlament nuk është ngritur asnjë çështje e vetme gjinore apo nevojat e femrave.¹⁴⁹

Edhe në Gjakovë, sikur në komunat tjera, janë ndërmarrë hapa për krijimin e Grupit Joformal të Grave, që përbëhet nga anëtarët e parlamentit. Megjithatë, në Gjakovë janë ende në procesin e përzgjedhjes së bordit dhe akoma nuk e kanë hartuar planin e veprimit.¹⁵⁰ Mbetet të shihet nëse anëtarët e parlamentit do të jenë në gjendje t’i kalojnë vijat e partisë në çështje që kanë të bëjnë me interesat e përbashkëta të grave.

Nëse ndikimi i politikanëve në vendimmarrjen komunale është i kufizuar, dëshmitë tregojnë që qytetarët kanë edhe më pak mundësi për pjesëmarrje.¹⁵¹ Udhëzimi Administrativ për Transparencë Komunale (2008/03) e lehtëson pjesëmarrjen e qytetarëve në takime publike dhe në rishikime të buxhetit. Megjithatë, pjesëmarrja e femrave në takime duket të ketë qenë minimale. Femrat fermere dhe zonjat e shtëpisë lanë të kuptohet se politikanët shumë

¹⁴⁶ KIPRED, 2010, pp. 9 dhe 27. Shih edhe also, KWN, ‘Plani Strategjik i KWN 2011-2013,’ f. 3, në: <http://www.womensnetwork.org/images/pdf/KWN%20Strategy%202011-2013.pdf>.

¹⁴⁷ Intervista e IKS me Mimoza Kusari-Lila, Zv. Presidente e AKR-së dhe ish-kandidate për kryetare të Gjakovës, Prishtinë, 4 Maj 2010.

¹⁴⁸ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku. Shih edhe KIPRED, f. 28.

¹⁴⁹ Bisedë telefonike e IKS me Rina Domi, anëtare e kuvendit, 2 Mars 2010.

¹⁵⁰ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku, Gjakovë, 24 Shkurt 2011.

¹⁵¹ Shih KIPRED.

rrallë takohen me to dhe që shumë rrallë ndërmarrin iniciativa të cilat do t'i trajtonin nevojat e tyre.¹⁵² Përveç kësaj, marrëdhëniet shoqërore në shoqërinë kosovare i pamundësojnë shumë femra që të jenë pjesë e vendimmarrjes brenda shoqërisë, e aq më pak të udhëtojnë jashtë shtetësisë së tyre që të marrin pjesë në takime komunale.¹⁵³ Sistemet e pamjaftueshme shtetërore për kujdes ndaj fëmijëve, për pensione, arsim dhe asistencë sociale të shoqëruar me role 'tradicionale' gjinore përbrenda familjes shpesh krijojnë situata ku femrat nuk kanë mundësi të barabarta për arsim, punësim apo vendimmarrje.

Sipas normave shoqërore, vajzat kanë tendenca të braktisin shkollën para djemve.¹⁵⁴ Më tepër se 65 përqind e femrave në Kosovë (krahasuar me përafërsisht 41 përqind të meshkujve) nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm.¹⁵⁵ Qasja e pabarabartë në arsim është edhe më e theksuar për femrat rurale, të cilat kanë nivelet më të ulëta të arsimit në Kosovë. Shkalla e papunësisë në mesin e femrave (56.9 përqind) është poashtu më e lartë se ajo në mesin e meshkujve (40.7 përqind).¹⁵⁶ Shkollimi dhe mundësitë jo të barabarta ekonomike, të shoqëruara me role gjinore, mund të ndikojnë në mundësinë e femrave për të marrë pjesë në vendimmarrje. Për shembull, ato mund të mos jenë në gjendje të marrin pjesë në takime publike për shkak të përgjegjësive në shtëpi (p.sh. për tu kujdesur për të moshuarit dhe fëmijët), për shkak të qasjes së pamjaftueshme në informata rreth takimeve dhe/ose mjeteve të pamjaftueshme financiare për të udhëtuar në këto takime.

Për më tepër, normat shoqërore tregojnë që vendimet tradicionalisht janë marr nga meshkujt më të moshuar të familjes.¹⁵⁷ Për femrat që jetojnë në 'bashkësi' (d.m.th. jeta me vjehrrin dhe vjehrrën, me anëtarë të familjes së gjerë ose në

¹⁵² IKS fokus grupi me femrat që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare, Gjakovë, 15 Korrik 2010. Zyrtarët e zgjedhur në përgjithësi nuk kanë lidhje me elektoratin e tyre. Për politikanet, kjo është kombinuar me burime të pamjaftueshme për femrat brenda partisë (shih KIPRED, f.24).

¹⁵³ Bazuar në një hulumtim në mbarë Kosovën, KWN zbuloi që meshkujt vendosin si do të shpenzohen paratë e familjes dhe kanë 'fjalën e fundit' kur duhet të merren vendime të rëndësishme (*Siguria Fillon në Shtëpi: Hulumtime për ta Informuar Strategjinë e Parë Kombëtare dhe Planin Veprimor kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: KWN, 2008).

¹⁵⁴ Numri mesatar i shkollimit të femrave në Komunën e Gjakovës është 8.45 vite, krahasuar me 10.35 vite për meshkujt (UNDP, *Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Kosovën: Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Zgjidhjet*, 2004, f. 119).

¹⁵⁵ ESK, *Rezultatet e Hulumtimit të Fuqisë Punëtore 2009*, Prishtinë: Korrik 2010, f. 14.

¹⁵⁶ *Po aty*, p. 13.

¹⁵⁷ Shih KWN, *Siguria Fillon në Shtëpi*.

shtëpi tradicionale), vendimet mirren nga mashkulli më i vjetër në familje ('zoti i shtëpisë'). Ai poashtu vendos se cilët anëtarë të familjes do ta vazhdojnë shkollimin e tyre apo do të punojnë jashtë shtëpisë dhe si do të shfrytëzohet buxheti i shtëpisë.¹⁵⁸ Rolet gjinore në këto ekonomi familjare zakonisht e kufizojnë pjesëmarrjen e gruas në jetën publike. Dhuna gjinore, e cila në mënyrë të shpërpjesëtuat ndikon femrat, në të njëjtën kohë ka ndikim aftësinë e femrave që t'i përmbushin të drejtat e tyre, përfshirë këtu pjesëmarrjen në ekonomi dhe qeverisje.¹⁵⁹

Derisa mundësitë e pabarabarta për shkollim, punësim dhe vendimmarrje ndikojnë në shumë femra në Kosovë, disa gra dhe vajza në komunën e Gjakovës janë jashtëzakonisht të pambrojtura në këtë aspekt. Prej të gjitha komunave të Kosovës, Gjakova ka pasur numrin më të madh të viktimave shqiptare gjatë luftës.¹⁶⁰ Në fshatrat si Korenica dhe Mejë kanë vdekur më tepër se gjysma e meshkujve. Fshati Dobrixhë, i cili dikur kishte 80 ekonomi familjare, sot ka vetëm 42 ekonomi familjare të udhëhequra nga femrat. 'Në çdo shtëpi është vrarë nga një anëtar i familjes,' thotë një banor. 'Ka familje që kanë më tepër se pesë anëtarë të vrarë.'¹⁶¹ Në fshatin Mejë, vetëm për një ditë janë vrarë 345 njerëz. 11 vjet më vonë, 23 meshkuj ende konsiderohen të zhdukur.¹⁶² Si rezultat i kësaj, komuna e Gjakovës ka numrin më të madh në Kosovë të ekonomive familjare të udhëhequra nga femrat. Vetëm në qytetin e Gjakovës, 600 femra kanë mbetur të veja gjatë luftës.¹⁶³

¹⁵⁸ IKS, *Rruga për Lisbonë: Qasja në nevojat e trajnimit profesional dhe krijimi i vendeve të punës për femrat në viset rurale*, Prishtinë: UNICEF, 2008, f. 36.

¹⁵⁹ Shih KWN, *Siguria Fillon në Shtëpi*.

¹⁶⁰ Sipas Rregullorës Nr. 2000/66 (2001) të Komunes së Gjakovës, numri i viktimave në Gjakovë në mes 28 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999 ishte: 220 dëshmorë të luftës; 202 luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjymtuar gjatë luftës; 471 viktima civile; 723 të zhdukur; 498 persona të rivarosur që nga 30 shtatori 2009; 134 civilë të gjymtuar gjatë luftës; 324 pengje të luftës; dhe 11 persona të vrarë në Burgun e Dubravës.

¹⁶¹ IKS fokus grupi me femrat që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare, Gjakovë, 15 Korrik 2010.

¹⁶² Komuna e Gjakovës, *Në përvjetorin e 11 vjetorit e Masakrës së Mejës në "Lëndinë e Ptkëllimit"* [11th Anniversary of the Mejë massacre in "Grief Valley"], 29 Prill 2010, shih: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/News/Ne-pervjetorin-e-11-vjetorit-e-Masakres-se-Mejes-n.aspx>.

¹⁶³ IKS e-mail komunikim me Merita Fejza, menaxhere në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve, Invalideve të Luftës dhe Familjeve të Viktimave Civile, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 4 Nëntor 2010. Përveç kësaj, 128 femra kishin burra që janë persona të zhdukur (IKS bisedë telefonike me Nesrete Kumnova, kryesuese e *Thirrjet e Nënave*, 4 Nëntor 2010.). Shumë prej burrave të tyre më vonë u gjetën në një varrezë masive, por 25 prej tyre akoma janë të zhdukur.

Femrat që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare janë ndër banorët më të pambrojtur dhe u kanoset rreziku më i lartë i varfërisë.¹⁶⁴ Për shkak të normave shoqërore, ato ballafaqohen me sfida të shtuara. Një udhëheqëse e ekonomisë së saj familjare shpjegon:

Gratë kanë mbetur me bonjakë dhe ata [familja] nuk iu lejojnë të largohen nga shtëpia [...] për shkak të gjërave që mund të thojnë të tjerët. Ato janë të izoluar [...] Ato dëshirojnë të punojnë, por kjo mundësi nuk u është lejuar. Drynjtë e tyre nuk po hapen.¹⁶⁵

Sigurimi i punës është betejë shumë e rëndë duke qenë që shumë pak gra kanë arisimim adekuat apo aftësi të tregtueshme.¹⁶⁶ PVPE-ja i bën thirrje Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të ofrojë ndërmjetësim për punë që do t'iu ndihmojë në mënyrë specifike grave të cilat futen në tregun e punës.¹⁶⁷ Megjithatë, sipas Drejtorit të Qendrës Rajonale për Punësim në Gjakovë (QRP), në një treg të punës ku konkurrenca është e madhe, mundësitë për punë për të vejat e luftës, të cilat kryesisht janë mbi 40-vjeç, janë 'pothuajse inekzistente.'¹⁶⁸ Edhe pse QRP-ja ofron mundësi për punë praktike me pagesë për të fituar përvojë pune, pjesëmarrësit shqiptarë duhet të jenë 30-vjeçar ose më të rinj ndërsa kandidatët nga komunitetet pakicë duhet të jenë 35-vjeçar ose më të rinj.

Ndihma sociale që ofrohet nga shteti ka bërë tejet pak për ta lehtësuar gjendjen e vështirë financiare të shumicës së femrave që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare. Familjet e dëshmorëve të luftës përfitojnë nga ndihma sociale e cila arrin totalin prej €239 në muaj.¹⁶⁹ Në Gjakovë, 126 femra përfitojnë nga kjo

¹⁶⁴ 28 përqind e femrave që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare jetojnë në varfëri krahasuar me 15 përqind të familjeve që udhëhiqen nga meshkujt (Komuna e Gjakovës, 'Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm e Komunës së Gjakovës, bazuar në Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit,' 2007, f. 52.

¹⁶⁵ IKS intervistë, Gjakovë, 15 Mars 2010.

¹⁶⁶ Në Gjakovë, 55 përqind të të regjistruarve si të papunë nuk kanë kualifikime adekuate dhe vetëm 29 përqind prej tyre e kanë përfunduar shkollën fillore (Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, 2010).

¹⁶⁷ PVPE, prioritet 21.4.

¹⁶⁸ Intervista e IKS me Kujtim Dula, Drejtor i Qendrës Rajonale për Punësim (QRP) në Gjakovë, 22 Mars 2010.

¹⁶⁹ Bazuar në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Anëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, Nr. 02/L-2, Neni 2, Sek. 2, 'Dëshmor i kombit është ai patriot i cili ka vepruar individualisht ose në një grup të organizuar për çështje kombëtare, i

ndihmë.¹⁷⁰ Fëmijët e tyre kanë qasje në libra shkollor falas, bursa dhe akomodim në konviktet universitare pa pagesë. Ato poashtu kanë tatime të më të ulëta të pronës dhe paguajnë tarifa më të vogla për energji elektrike, në mes beneficioneve tjera që i gëzojnë.¹⁷¹

Megjithatë, jo të gjitha ekonomitë familjare të udhëhequra nga femrat kualifikohen për këto beneficione. 474 familjet e viktimave civile të luftës marrin më pak ndihmë sociale sesa familjet e dëshmorëve: vetëm €135 në muaj.¹⁷² Kjo ndihmë sociale nuk mjafton për t'i mbuluar nevojat e tyre. Fëmijët e tyre nuk përfitojnë libra shkollor apo bursa falas. Si rezultat i kësaj, 'Të gjitha vajzat dhe djemtë janë të ngujuar në shtëpi,' shpjegon një udhëheqëse e ekonomisë së saj familjare. 'Si mund t'i dërgosh në shkollë me buxhet prej €135? Cilat obligime do t'i paguash më parë?'¹⁷³ Me fonde të kufizuara familjare dhe me gjasa më të ulëta për të siguruar një vend të punës më vonë në jetë, vajzat janë të prirura t'i braktisin mësimet më herët se djemtë. Gjatë bisedave me gratë në vise rurale, kuptuam që komuna nuk po e përmbush obligimin e saj për t'i integruar të gjithë fëmijët në sistemin shkollor të Kosovës, në veçanti grupet e ndjeshme.¹⁷⁴

'Si mund t'i dërgosh në shkollë me buxhet prej €135? Cilat obligime do t'i paguash më parë?'

Një çështje tjetër e rëndësishme janë të drejtat pronësore të gruas, që janë kyçe për femrat që udhëheqin ekonomi familjare në viset rurale në emër të një anëtari mashkull të familjes. Kur ky i fundit ndërrohet,

cili është vrarë në forma të ndryshme ose ka rënë në betejë kundër okupatorit gjatë të gjitha periudhave të luftës për liri.'

¹⁷⁰ IKS e-mail komunikim me Merita Fejza, menaxhere në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Familjeve të Viktimave Civile, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 4 Nëntor 2010.

¹⁷¹ Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Anëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, Neni 6.1.

¹⁷² IKS e-mail komunikim me Merita Fejza.

¹⁷³ Intervista e IKS me Xhyle Hyseni, femër në krye të ekonomisë së saj familjare, Gjakovë, 15 Mars 2010.

¹⁷⁴ PVPE, prioritetet 42.1, 42.2 123.9. Edhe pse nuk diskutohet këtu, PVPE-ja poashtu ju bën thirrje autoriteteve komunale që të përfshihen në hartimin e 'programeve dhe kurrikuleve nga perspektiva gjinore' (PVPE, prioritet 39.7).

prona rrallëherë regjistrohet në emrin e femrës. Prona shpeshherë mbetet në emrin e burrit apo bartet në emrin e ndonjë pjesëtari tjetër mashkull të familjes. Shumë femra nuk janë të njoftuara për të drejtën e tyre ligjore për të trashëguar pronë, siç ceket në Ligjin për Trashëgimi të Kosovës.¹⁷⁵ Ato femra që e njohin këtë të drejtë, fakti që duhet ta kërkojnë pronën nëpërmjet ligjit me të gjithë anëtarët e familjes prezent, i dekurajon ato që ta kërkojnë këtë të drejtë. Anëtarët e familjes iu bëjnë presion femrave që të mos bëjnë këso kërkesa, dhe zakonisht femrat vendosin mos t'i acarojnë marrëdhëniet, posaçërisht në raste kur ato kanë varësi shoqërore dhe financiare nga familjet e tyre.¹⁷⁶

Për gratë që dëshirojnë ta kërkojnë pronën e tyre, problem ka paraqitur kostoja financiare e regjistrimit të pronës në emrin e tyre. Një grua shpjegon:

Vitin e kaluar e kemi bartur pronën në emrin e familjes sime, dhe e kemi ndarë atë nga bashkësia. Kjo na ka kushtuar rreth €900. Është dashur ta bartim pronën nga disa gjenerata më të vjetra në emrin tonë dhe kjo na ka kushtuar me para dhe kohë. Kostot për kompletimin e dokumenteve ishin shumë të larta pasi që duhej ta paguanim avokatin, gjyqin dhe tarifat për të gjitha dokumentet plotësuese. Zonjat e shtëpive duhet ta kenë pronën në emrin e tyre [...] në mënyrë që të kenë të ardhme të qartë.¹⁷⁷

Të drejtat e padefinuara pronësore ndikojnë në shumë fusha të jetës së gruas, përfshirë këtu edhe qasjen në tokë të punueshme dhe kontrollin mbi burimet financiare të familjes. Gratë të cilat mund të marrin kredi për zhvillimin e bizneseve të tyre nuk mund ta bëjnë këtë sepse nuk posedojnë kolateral të patundshëm. Duke i marrë parasysh këto çështje, të drejtat pronësore mund të jenë fushë kyçe për Agjencinë për Barazi Gjinore gjatë hartimit të Strategjisë për Fuqizimin Ekonomik të Gruas,

¹⁷⁵ Ligji për Trashëgiminë në Kosovë, No. 2004/26, 2004, Neni 12.1.

¹⁷⁶ IKS fokus grupi me femrat në krye të ekonomive të tyre familjare, Gjakovë, 15 Korrik 2010.

¹⁷⁷ *Po aty*.

siç parashihet në PVPE.¹⁷⁸ Në të njëjtën kohë, Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Zyren Kadastrale, mund t’iu ofroj subvencione grave që i regjistrojnë pronat në emrin e tyre. OJQ-të e grave poashtu mund ta vazhdojnë vetëdijësimin për të drejtat pronësore të gruas. Grave duhet t’u jepen edhe më tepër informata rreth ndihmës ligjore falas që e ofrojnë Zyrat për Ndihmë Ligjore.

Në përgjithësi, siç tha Zyrtarja Komunal për Barazi Gjinore në Gjakovë, ‘Kosova ka shumë ligje por problemi është tek zbatimi i tyre.’¹⁷⁹ Dëshmitë tregojnë që zbatimi i kornizës ekzistuese ligjore për të drejtat e gruas në pronë, pjesëmarrje publike, arsim dhe punësim në praktikë kërkon ndryshime rrënjësore në normat, marrëdhëniet dhe praktikat ekzistuese. Komuna mund të ndërmerri një rrugë më të drejtpërdrejt drejt anëtarësimit në BE duke i përmbushur obligimet e saj ligjore për të drejtat e gruas dhe barazinë gjinore.

Nevojiten përpjekje për ta shtyer më tutje pjesëmarrjen aktive dhe të fuqizuar të grave në vendimmarrje që ndikon jetën e tyre. Anëtarët e kuvendeve komunale dhe ZBGJ duhet të zhvillojnë mekanizma më të mirë për angazhimin e gruas, posaçërisht të atyre grave që deri tash janë të margjinalizuara. Femrat duhet të konsultohen në procesin e hartimit të programeve të partive politike, planeve të punës të departamenteve dhe në përgatitjen e buxhetit. Me që shumë femra nuk kanë mundësi të marrin pjesë në takimet publike të kuvendeve komunale, ZBGJ duhet të organizojë takime nëpër fshatra në mes grave rurale dhe përfaqësuesve komunal. Anëtarët e kuvendeve komunale, ndoshta nëpërmjet Grupit Joformal të Grave, poashtu mund të takohen më shpesh me elektoratin e tyre. Kjo mund ta forcojë zërin e politikaneve në kuvend komunal me që ato mund ta rrisin elektoratin e tyre. Zhvillimi i mëtutjeshëm i komunikimit në mes votuesve femra dhe politikaneve mund t’iu japë politikaneve një bazë elektorale edhe për zgjedhjet e ardhshme.

¹⁷⁸ PVPE, prioritet 39.9.

¹⁷⁹ Intervista e IKS me Lumnije Shllaku, Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Koordinatore e Njësisë për të Drejtat e Njeriut, Gjakovë, 24 Shkurt 2011.

OJQ-të e grave mund të luajnë rol të rëndësishëm në konsultime me gratë dhe në vetëdijësimin e vendimmarrësve komunal për brengat e tyre. Një iniciativë premtuese në drejtim rritjes së pjesëmarrjes së grave deritash të marginalizuara në vendimmarrje është shoqata e fermereve, *Duart e Dardanes*. Shoqata synon ta fuqizojë pjesëmarrjen e barabartë të gruas në zhvillime ekonomike dhe politike.¹⁸⁰ Anëtarët e saj në tetë fshatra të Gjakovës, kryesisht zonja të shtëpisë, kanë zgjedhur përfaqësueset dhe kryetaren e tyre, kanë hartuar planin strategjik dhe kanë vijuar trajnimin për avokim.

Zyra për Barazi Gjinore duhet ta zhvendosë përqendrimin e saj nga përpjekjet aktuale për vetëdijësim në monitorim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe zbatimit të mëtutjeshëm të legjislacionit kombëtar në nivel lokal, siç parashihet në PVPE. Planet e punës duhet të hartohen bazuar në analizën e problemeve dhe menaxhimin e bazuar në rezultate kah përmbushja e objektivave afatgjate kombëtare. ZBGJ duhet të sigurohet që gjatë hartimit të planit të punës, planifikimit komunal, buxhetimit dhe politikave, të merren parasysh nevojat e ndryshme të femrave dhe meshkujve. Në këtë drejtim, tutorim i mëtutjeshëm në vend të punës mund të aftësojë ZBGJ-në në menaxhimin e ciklit të projekteve/programeve.

Duke marrë parasysh natyrën relacionale të gjinisë, zhvillimi i mëtutjeshëm i të drejtave të gruas nuk mund të ‘ekzistojë në vakuum’ (siç parashihet në PVPE-në aktuale), por duhet të trajtojë marrëdhëniet shoqërore në mes femrave dhe meshkujve.¹⁸¹ Meqë marrëdhëniet gjinore kanë ndikim mbi politikën, transformimi i marrëdhënieve gjinore në Gjakovë (dhe më tej) dhe institucionalizimi i barazisë gjinore kërkojnë zhvendosje në marrëdhëniet ekzistuese në mes femrave dhe

¹⁸⁰ Ka marrë përkrahje nga medica Kosova, KËN dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.

¹⁸¹ Shih F. Cleaver, ‘Institutions, agency and the limitations of participatory approaches to development,’ in B. Cooke & U. Kothari (Eds.), *Participation: The New Tyranny?* London: Zed Books, 2001, pp. 272-3.

meshkujve.¹⁸² Kjo bën të nevojshme që të ketë vëmendje jo vetëm ndaj ‘femrave’ por edhe ndaj meshkujve, interesave të tyre si dhe pozitës së tyre krahasimisht të privilegjuar në shoqëri (p.sh. sa i përket trashëgimisë, pronës, qasjes në shkollim dhe punë).¹⁸³

PVPE-ja dështon në aspektin e institucionalizimit të barazisë gjinore: duke e kategorizuar barazinë gjinore si ‘çështje e të drejtave të njeriut’, PVPE-ja nuk e trajton gjininë në aspektet tjera të planit. Për shembull, PVPE-ja nuk përmend se si privatizimi dhe politikat e reja ekonomike mund të kenë ndikim të ndryshëm tek femrat dhe meshkujt, apo cilat politika sociale mund të nevojiten për trajtimin e këtyre pabarazive.¹⁸⁴ PVPE-ja duhet të shqyrtojë me kujdes më të madh implikimet gjinore të të gjitha ndryshimeve të propozuara të politikave.

Të anashkaluar? Romët, ashkalijët dhe egjiptasit në Gjakovë

Në dhjetor të vitit 2008, Qeveria e Kosovës e miratoi ‘Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase në Republikën e Kosovës.’ Në pajtim me Kushtetutën e Republikës, Strategjia synon promovimin dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave, integrimin e tyre të plotë si dhe fuqizimin e tyre politik nëpërmjet dialogut dhe inkurajimit të përfaqësuesve të komuniteteve të tyre.¹⁸⁵ PVPE-ja bën thirrje për zbatimin e Strategjisë.¹⁸⁶

Zëvendës kryetari i Kuvendit Komunal të Gjakovës është egjiptas i Kosovës (Bislim Hoti), dhe komuna po ashtu ka themeluar një

¹⁸² Për më tepër rreth ‘institucionalizimit’ vs. mainstreaming gjinor, shih C. Levy, ‘Institutionalization of Gender through Participatory Practice,’ in I. Guijt & M. K. Shah (Eds.), *The Myth of Community*, London: Intermediate Technology Publications, 2001.

¹⁸³ Shih S. White, ‘Men, masculinities, and the politics of development,’ *Gender and Development*, 5(2), 14-22, 1997, and S. White, ‘Depoliticising development: the uses and abuses of participation,’ in D. Eade (Ed.), *Development, NGOs and Civil Society*, Oxford: Oxfam, 2000.

¹⁸⁴ Intervista e IKS me Flora Macula, Këshilltare për Paqe dhe Qeverisje, Gratë e OKB-së, Prishtinë, 12 Korrik 2010.

¹⁸⁵ Zyra e Kryeministrit, Republika e Kosovës, ‘Strategjia për Integrimin e Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve,’ Dhjetor, 2008, p. 5.

¹⁸⁶ PVPE, prioritet 45.5.

komision të komuniteteve për përmirësimin e gjendjes politike dhe sociale të komuniteteve pakicë.¹⁸⁷ Komuna e Gjakovës ka edhe Zyrën për Komunitete, e cila është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe promovimin e mundësive të barabarta për pakicat në qasjen në shërbime publike. Zyra ka buxhet mjaft të kufizuar dhe ka katër nëpunës.¹⁸⁸ Zyra ka hartuar planin e veprimit për integrimin e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase në Komunën e Gjakovës, mirëpo ky dokument akoma duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal.¹⁸⁹

Këto tri grupe etnike, të cilat shpesh quhen edhe ‘Komuniteti RAE’ (edhe pse ky term nuk është i saktë sepse këto janë grupe të ndryshme etnike e jo pjesëtarë të një ‘komuniteti’ të vetëm), janë në mesin e grupeve më të marginalizuara ekonomikisht në Gjakovë.¹⁹⁰ Përderisa një numër faktorësh kontribuojnë në varfërimin e tyre, është niveli i ulët i shkollimit ai i cili në veçanti e kufizon qasjen e këtyre komuniteteve në punësim në tregun formal të punës. Shumë familje nuk janë në gjendje t’i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë si rezultat i nivelit të ulët të shkollimit në mesin e prindërve si dhe për shkak të fondeve të kufizuara.¹⁹¹ Prandaj, fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptas shpesh regjistrohen në shkollë më vonë se moshatarët e tyre shqiptarë.

Pas shkollës fillore, një numër i vogël i të rinjve nga këto komunitete vijojnë mësimet në shkollë të mesme.¹⁹² Për shkak të gjendjes së mjerë socio-ekonomike, shumë prej tyre duhet t’i braktisin mësimet për të punuar dhe për t’i përkrahur familjet e tyre. ‘Çdo gjë mvaret nga

¹⁸⁷ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, Neni 53; Republika e Kosovës, 2008. Komisioni ka shtatë anëtarë: një romë, dy egjiptas, një ashkali, një boshnjak të Kosovës dhe dy shqiptarë të Kosovës.

¹⁸⁸ Buxheti i Zyres për Komunitete parashihet të jetë €24,000 për vitin 2011 (për paga, produkte dhe shërbime). Komuna e Gjakovës, ‘Korniza Afatmesme e Buxhetit 2011-2013,’ f. 9.

¹⁸⁹ E-mail komunikim me Armend Behluli, Kryesues i Zyres për Komunitete, 28 Shkurt 2011.

¹⁹⁰ Intervista e IKS me Kapllan Kërshi, Zyrtar Komunal për Komunitete, 28 Korrik 2010.

¹⁹¹ ECMI, Doracaku për Zyrtarë Komunal, *Mbrojtja dhe Promovimi i Arsimit për Komunitetet Pakicë*, Mars 2010, f. 10.

¹⁹² Bazuar në statistikat e Komunës gjatë vitit shkollor 2009/2010, 1,435 të rinj RAE kanë vijuar mësimet në shkollë fillore dhe vetëm 89 në shkollë të mesme (Intervista e IKS me Silvana Haxhikadrija, drejtoreshë e Departamentin Komunal për Arsim, 16 Shtator 2010).

ekonomia,' thotë një përfaqësues i Zyrës Komonale për Komunitete. 'Pa zhvillim ekonomik nuk ka as stimulim për të shkuar në shkollë. Këto familje luftojnë për mbijetesë.'¹⁹³

Të rinjtë në 'Koloninë Rome' shpjegojnë që edhe tradita i kufizon shpresat e tyre për një të ardhme më të mirë.¹⁹⁴ Shembull tipik i kësaj është Mile, një vajzë 14-vjeçare e lindur në Gjermani dhe momentalisht në klasën e shtatë me një qëndrim të mirë. Përkundër qasjes së saj pozitive dhe suksesit në shkollë, ajo mendon që do t'i braktis mësimet vitin e ardhshëm. Ajo nuk i tregon arsyet për këtë, por kolegët e saj shpjegojnë që tashmë kanë filluar 'përgatitjet për martesë.' Në mënyrë paradoksale, shumë të rinj në grupin e fokusit ishin të vetëdijshëm që shkollimi mund t'iu ofrojë jetë më të mirë. Megjithatë, ata thonë që shumica e banorëve të Kolonisë janë të pakënaqur me ata që shkojnë në shkollë në vend se të martohen.

Me qëllim për të adresuar ndërprerjen e shkollimit në mesin e fëmijëve, dy qendra edukative ofrojnë trajnime për fëmijët e Kolonisë Rome dhe Dardanisë. Samaritan Purse (SP) dhe Bethany Christian Services i udhëheqin këto qendra. SP poashtu ka nisur një program pas orëve mësimore për t'i përgatitur fëmijët për shkollat publike. Përveç mësimave për nxënës dhe inkurajimit të tyre që të mbesin në shkollë, stafi i SP-së i viziton edhe familjet e të rinjve.¹⁹⁵ Edhe pse përkrahja dhe programet e këtyre organizatave ndërkombëtare janë shumë të rëndësishme, ato mund të mos jenë të qëndrueshme në plan afatgjatë. Autoritetet komunale duhet të jenë më të përkushtuar dhe të sigurojnë që të gjithë nxënësit të kenë qasje në shkollim, në përputhje me PVPE-në.¹⁹⁶ Komuna mund të angazhojë më tepër mësues për të ligjeruar në

¹⁹³ Intervista e IKS me Kapllan Kërshi, Zyrtar Komunal për Komunitete, 28 Korrik 2010.

¹⁹⁴ IKS fokus grupi me të rinj romë, ashkali dhe egjiptas, Kolonia Rome në Gjakovë, 31 Gusht 2010.

¹⁹⁵ Ata sigurojnë që familjet marrin përkrahje të mjaftueshme, qoftë financiare apo e natyrës tjetër, për t'iu ndihmuar fëmijëve që mos ti braktisin mësimet. Stafi i SP janë poashtu në kontakt të vazhdueshëm me fëmijët. Ata thonë që kjo e mundëson menaxhimin 'trekëndësh': 'trekëndëshin' fëmi-familje-mësues, i nevojshëm për vazhdimin e arsimit të fëmijëve (IKS intervistë grupore me stafin e SP, 11 Gusht 2010).

¹⁹⁶ PVPE, prioritet 42.

gjuhën rome, të synojë të përfshijë më tepër romë në edukim parashkollor, të hartojë planprogram në gjuhën rome dhe të ofroj bursa për fëmijët romë, përsëri në pajtim me PVPE-në.¹⁹⁷

Rasti i braktisjes së shkollimit nga ana e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas nuk është i veçantë vetëm për qytetin e Gjakovës por shfaqet pothuajse anëmbanë Kosovës. Megjithatë, komunat mund të lehtësojnë gjetjen e zgjidhjeve adekuate. Komponenti i Arsimit i Strategjisë për Integrimin e Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve në Kosovë, përveç politikave tjera të veprimit afirmativ, bën thirrje hapjen e vendeve të punës për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në Departamentet Komunale të Arsimit.¹⁹⁸ Megjithatë, komuna e Gjakovës akoma nuk e ka zbatuar këtë kërkesë.

Njëra prej mënyrave të pakta nëpërmjet të cilave lagjet e banuara kryesisht me romë, ashkalinj dhe egjiptas mund t'i parashtrajnë brengat e tyre është 'përfaqësimi i lagjes.' Përfaqësuesi i lagjes nuk është person ligjor por personi i kontaktit në lagje për OJQ-të, ofrimin e donacioneve dhe asistencës. Roli i 'përfaqësuesit të lagjes' është të identifikojë nevojat e 'komunitetit' dhe në bashkëpunim me OJQ-të të hartoj projekt propozime të cilat i sjellin përfitime komunitetit. Megjithatë, në praktikë, përfaqësuesit e lagjeve nuk janë treguar efektiv.

Një gabim qenësor në qasjen e 'përfaqësuesit' dhe 'komunitetit' është që trajtojnë çështjet me të cilat ballafaqohen romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit thuase të gjitha janë të njëjta, duke i njësuar dallimet etnike, moshore dhe gjinore. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit nuk përfaqësojnë një grup të vetëm homogjen me role dhe pozita të njëjta shoqërore.¹⁹⁹ Politikat e 'komunitetit' dhe 'përfaqësuesit të lagjes' jo domosdoshmërisht i përfaqësojnë nevojat e të gjithë banorëve të zonës

¹⁹⁷ PVPE prioritetet 42.7, 68.4 dhe 68.5.

¹⁹⁸ Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë: Korrik 2007, p. 29.

¹⁹⁹ Ashkali konsiderohen romët e asimiluar që flasin shqip (UNDP, *Në Rrezik: Romët dhe të Zhvendosurit në Evropën Juglindore*, 2006, f. 13) që është një arsye tjetër pse fëmijët e tyre kanë qasje në shkollim (në gjuhën shqipe) dhe dikush pohon edhe më tepër mundësi për mobilitet shoqëror.

sepse ato mund të dallojnë shumë njera prej tjetrës (p.sh., moshë, gjinia dhe statusi).

Në fakt procesi i caktimit të përfaqësuesit në vetvete ka qenë jopërfaqësues: meshkuj të moshuar (zotët e shtëpive) dhe një numër i vogël i grave e zgjodhën përfaqësuesin gjatë takimit të bashkisë.²⁰⁰ Gjatë këtij procesi nuk u morr parasysh një numër i madh i ‘Kolonisë Rome’ përfshirë këtu gratë dhe të rinjtë. Një vajzë e re theksoi që brengat dhe nevojat e tyre nuk janë të rëndësishme për përfaqësuesit. Sipas saj, autoritetet komunale apo ‘përfaqësuesit’ nuk ‘i shohin e as dëgjojnë’ të rinjtë në këtë lagje.²⁰¹

Banorët i shohin përfaqësuesit e lagjeve si njerëz të korruptuar e vetjak dhe vjedhës të donacioneve që destinuar për ‘komunitetin’ dhe si persona që janë indiferent ndaj nevojave të “qytetarve” të tyre.²⁰² Ka pasur përpjekje për rivitalizimin e mekanizmave të përfaqësimit nëpërmjet punëtorëve për ndërtimin e kapaciteteve të përfaqësuesit e lagjeve.²⁰³ Megjithatë, duke marrë parasysh problemet fundamentale me konceptin e ‘përfaqësimit,’ takimet kolektive të shoqëruara me diskutime individuale me pjesëtarët më të pambrojtur të ‘komuniteteve’ mund të jenë më produktive.

Në përputhje me PVPE-në, Komuna e Gjakovës ka dhënë 3.8 hektarë tokë për ndërtimin e lagjes së re e cila do të ketë 125 shtëpi për banorët e Kolonisë Rome.²⁰⁴ Në projekt është paraparë komuniteti urban me qendër mjekësore dhe një godinë parashkollore. Çmimi i përafërt i projektit është €3.4 milion, të sigurara nga Caritas-i Zvicëran dhe disa

²⁰⁰ Procesi i votimit është i hapur, qoftë me dorë apo me nënshkrimin e njerës prej dy kolumnave me emrat e kandidatëve të caktuar, të listuar njëri mbi tjetrin.

²⁰¹ IKS fokus grupi me të rinj Roma, Ashkalijë dhe Egjiptian, Kolonia e Romëve në Gjakovë, 31 Gusht 2010.

²⁰² IKS fokus grupi me të rinj Roma, Ashkalijë dhe Egjiptian, Kolonia e Romëve në Gjakovë, 31 Gusht 2010.

²⁰³ Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), financuar nga Bashkimi Evropian dhe Fondacioni Soros, ofron zhvillim të kapaciteteve për ‘përfaqësuesit e komuniteteve.’

²⁰⁴ PVPE, prioritet 45.

donatorë të tjerë.²⁰⁵ Ndërtimi i lagjes, i cili ka filluar në tetor të vitit 2010, do të zgjasë tre vite. Koha do të dëshmojë nëse kjo iniciativë do të jetë e qëndrueshme në planin afatgjatë. Ka brenga nëse përfituesit e banimit të lirë do të jetojnë në këto shtëpi apo do t'i shesin ato për përfitim afatshkurtër, siç ka qenë rasti në qytetin e Mitrovicës.²⁰⁶ Përveç kësaj, projekti i ri për banim është vetëm disa kilometra larg Kolonisë Rome. Prandaj, banorët e pakicave do të mbesin të përjashtuar në aspektin shoqëror; disa mendojnë që integrimi i pakicave me shumicën do të ishte zgjidhje më e qëndrueshme.²⁰⁷

Për të siguruar që qytetarët romë, ashkalinj dhe egjiptas nuk do të anashkalohen në rrugën drejt zhvillimit dhe anëtarësimit në BE, nevojiten përpjekje për t'i transformuar normat ekzistuese shoqërore në mesin e qytetarëve të komunitetit shumicë për përfshirjen më të qëndrueshme të këtyre tri komuniteteve. Përfshirja shoqërore ndodh në nivelin lokal dhe si e tillë duhet të analizohet brenda kontekstit të kushteve të komunitetit shumicë.²⁰⁸ Meqë komuniteti shumicë banon në mjedisin e njëjtë socio-ekonomik si romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, nevojitet një qasje gjithpërfshirëse e cila e merr parasysh shumicën në mënyrë që të gjenden zgjidhje për çështjet me të cilat ballafaqohen pakicat.²⁰⁹ Në vend se të trajtohen çështjet e pakicave në mënyrë të pavarur, problemet siç janë varfëria, arsimi dhe punësimi duhet të shihen si 'sfida zhvillimore multisektoriale' të cilat duhet të trajtohen nëpërmjet një qasje gjithpërfshirëse të 'zhvillimit të bazuar në zonë.' Duhet bërë përpjekje për t'i trajtuar marrëdhëniet shoqërore dhe për gjetjen e fondeve të mjaftueshme për jetesë për grupet e pambrojtura. Në këtë drejtim, politikat mund t'i stimulojnë bizneset dhe punësimin e

²⁰⁵ Intervista e IKS me Ekipin e Jashtëm Monitorues në Gjakovë, 11 Tetor 2010. Bethany Christian Services poashtu ka përkrahur zhvendosjen e kampit dhe ndërtimin e shtëpive të reja (Intervista e IKS me Berat Thaqi, Drejtor Ekzekutive, Bethany Christian Services, 1 Prill 2010).

²⁰⁶ *Koha Ditore* raport online "Disa romë shesin apartamentet e tyre në jug dhe kthehen përsëri në veri", 30 Mars 2010, në http://www.koha.net/index.php?cid=1_8_16390.

²⁰⁷ Intervista e IKS me Besnik Luboja, staf i OJQ'së Çanta Samaritane, Gjakovë, 11 gusht 2010.

²⁰⁸ UNDP, *Në Rrezik: Romët dhe të Zhvendosurit në Evropën Juglindore*, 2006, f. v.

²⁰⁹ *Po aty*.

pakicave nëpërmjet shërbimeve të punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, në përputhje me PVPE-në.²¹⁰

Në përfundim, duket se ekzistojnë tema që përsëriten sa i përket gjendjes së vështirë të të rinjve, grave dhe pakicave rome, ashkali dhe egjiptase si grupe posaçërisht të pambrojtura në Gjakovë. Në rastet më të mira, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në Gjakovë ka qenë sa për sy e faqe. Pjesëmarrja formale, për dallim nga format më të fuqizuara të pjesëmarrjes, nuk paraqet sfidë për marrëdhëniet dominuese të fuqisë, i injoron rastet e shpeshta të konfliktit të interesave në vendimmarrje dhe i fsheh pabarazitë në mesin e grupeve në dukje të parë homogjene (p.sh. ‘gratë’ ose ‘RAE-të’).²¹¹ Nevojiten përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive dhe të fuqizuar në vendime që kanë ndikim në jetën e tyre. Takimet e ralla dhe jo mirë të promovuara publike si dhe ‘përfaqësuesit’ jopërfaqësues nuk janë treguar të suksesshëm. Përfaqësimi i interesave të kategorive të caktuara të njerëzve apo të komunitetit (gabimisht të homogjenizuar) nuk duhet të shihen si kontribut i ‘përfaqësuesve.’ Në fakt, termi ‘Komunitetet RAE’ është i gabueshëm dhe duhet t’i kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të ndryshme të të rinjve dhe të moshuarave, si dhe të grave dhe meshkujve. Komuna mund ta çojë edhe më tutje përfshirjen e personave të pambrojtur në vendimmarrje, planifikim dhe buxhetim duke zhvilluar konsultime të drejtpërdrejta me qytetarët e pambrojtur dhe jo të pres që këta qytetarë t’i vizitojnë zyret e tyre.

Për të bërë konsultime efektive me grupet e pambrojtura, si dhe për t’iu përgjigjur brengave që i shtrojnë qytetarët, Komuna duhet të mendojë t’i përdorë në mënyrë më efektive burimet e saj të kufizuara financiare

²¹⁰ PVPE, prioritetet 7.3 dhe 21.3.

²¹¹ Shih Chambers, R., ‘Paradigm shifts and the practice of participatory research and development,’ [*Paradigma ndryshon në praktikat e hulumtimit pjesmarrës dhe zhvillimit*] në N. Nelson & S. Wright (Ed.), *Poëer and Participatory Development*, [Fuqia dhe zhvillimi pjesmarrës] London: IT Publications, 1995; dhe White, S., ‘Depoliticising development: the uses and abuses of participation,’ [*Depolitizimi i zhvillimit: përdorimet dhe keqpërdorimet e pjesëmarrjes*] in D. Eade (Ed.), *Development, NGOs and Civil Society*, [*Zhvillimet, OJQ-të dhe Shoqëria Civile*] Oxford: Oxfam, 2000.

dhe njerëzore. Qenësore në këtë drejtim janë emërimet e vetme, buxhetet e mjaftueshme, trajnimet dhe ekspertiza adekuate në fushat e tyre, njohuria mbi menaxhimin e ciklit të projekteve dhe zbatimi i planeve që kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve dhe synimeve afatgjata kombëtare.

Qasja në arsim është një çështje tjetër serioze. Familjet rome, ashkali dhe egjiptase si dhe zonjat e shtëpive në viset rurale në veçanti nuk kanë mjete të mjaftueshme për dërgimin e fëmijëve të tyre në shkollë apo për blerjen e librave shkollor. Si pjesë e përgjegjësisë së tyre për ‘ritjen e shkallës së vijimit të mësimin në të gjitha nivelet,’ komunat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjithë vajzat dhe djemtë e grupeve të ndryshme etnike mund të shkojnë në shkollë.²¹² Në këtë drejtim, Komuna duhet të ofroj libra dhe transport falas për të gjithë nxënësit.

Pastaj mund të caktohen programe të praktikës dhe politika të veprimit afirmativ për angazhimin e grupeve të ndjeshme, përfshirë këtu të rinjtë, pakicat dhe femrat mbi moshën 40 vjeçare. Në fakt, PVPE-ja përfshin në mesin e prioriteteve afatshkurte ‘Ndërmjetësimin e punësimit nëpërmjet Shërbimeve Publike të Punësimit të grupeve që ballafaqohen me vështirësi për t’u kyçur në tregun e punës (personat e papunë për një kohë të gjatë, gratë, RAE-të dhe personat me aftësi të kufizuara).’²¹³ Përderisa kjo bie nën përgjegjësinë e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komuna mund të mendojë për uljen e tatimeve dhe tarifave për punëdhënës që punësojnë grupet e ndjeshme, drejt integritimit shoqëror. QPR-ja lokale poashtu mund të synojë të prioritetizojë trajnimet, praktikat dhe gjetjen e vendeve të punës për individët më të pambrojtur, në përputhje me PVPE-në.

Përveç kësaj, do të nevojitet një qasje gjithpërfshirëse ndaj zhvillimit të bazuar në zonë e cila i merr parasysh relacionet e moshës, gjinisë dhe

²¹² PVPE, prioritet 123.9.

²¹³ PVPE, prioritetet 21.3 dhe 21.4.

etnicitetit, për tu siguruar që banorët më të pambrojtur të Gjakovës do të jenë në rrugë drejt zhvillimit njerëzor dhe anëtarësimit në BE.

III. BRUKSELI APO DËSHTIMI

Ky punim ka synuar të identifikojë ndryshimet e politikave që mund ta vendosin Gjakovën në rrugë drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe zhvillimit njerëzor drejt anëtarësimit në BE, duke e përdorur qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut.

Më gjërësisht, autoritetet qendrore dhe ministritë në nivelin qendror duhet të hartojnë një **plan të realizueshëm të zhvillimit ekonomik**, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra në rrafshin komunal. Në hartimin dhe zbatimin e planit duhen përfshirë grupet e ndryshme të interesit në mënyrë që të sigurohet pronësia dhe që dokumenti ‘të jetë i gjallë.’ Plani duhet të fokusohet në zhvillimin e pamjaftueshëm të bujqësisë, prodhimin dhe sektorin e përpunimit si dhe në zrvillimin e tregëtisë. Plani do të duhet po ashtu të sigurojë përkrahje të vazhdueshme ndërkombëtare, qoftë në aspektin e donacioneve, investimeve apo asistencës teknike.

Deri më sot, një sërë pengesash e kanë ngadalësuar procesin e privatizimit. Për ta përshpejtuar progresin drejt rritjes ekonomike në Gjakovë, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme duhet t’i zgjidhë rastet e privatizimit dhe APK-ja duhet ta **përshpejtojë procesin e privatizimit**. Privatizimi i plotë dhe konsolidimi i tokës janë kyçe për investime dhe për identifikimin e tokës për zhvillim bujqësor. Pas kësaj, investimet, planet e fuqishme afariste si dhe sigurimi i tregjeve të reja do të jenë shumë të rëndësishme që ish-ndërmarrjet shoqërore të sigurojnë tregje të reja.

Drejt stimulimit të rritjes ekonomike, vëmendje më e madhe duhet t’i kushtohet **zhvillimit të sektorit privat**. Autoritetet qendrore dhe komunale mund ta stimulojnë rritjen e sektorit privat duke e përkrahur konkurrencën e drejtë dhe duke e minimizuar ekonominë joformale. Ato po ashtu mund të lehtësojnë dhe përshpejtojnë procedurat për regjistrimin e bizneseve. Duke marrë parasysh ritmin e tyre të breshkës deri tani, NSH-të e privatizuara dhe bizneset bujqësore kanë nevojë për plane të realizueshme afariste të shoqëruara me investime domethënëse teknike dhe financiare. Procesimi duhet të krijojë më shumë fitim, që ndikon në ngritje të rrogave dhe kërkesës. Kjo mund të jetë trampolinë për sektorin e dobësuar të tregëtisë.

Duke pasur parasysh popullatën e gjërë rurale të Gjakovës dhe aftësitë arsimore, **stimulimi i sektori bujqësor në veçanti** mund të jetë edhe çelësi për intervenim i qeverisë lokale. Tradicionalisht njëri prej sektorëve më të mëdhenj ekonomik të Gjakovës sektori i bujqësisë ka mundësi të mëdha për rritje ekonomike. Një ligj më fleksibil për punimin e tokës mund t'iu mundësojë bujqëve ta punojnë tokën e njerëzve të tjerë, duke e mundësuar kështu një treg më fleksibil. Duke kombinuar tokën, teknologjitë, teknikat dhe njohuritë, bujqit mund t'i rrisin të ardhurat e tyre dhe të garojnë në treg. Shoqatat e prodhuesve po ashtu mund të kenë ndikim në zbutjen e ndarjes së tokës dhe do të lehtësonte marketingun e përbashkët të produkteve si dhe do ta rriste fuqinë e prodhuesve të vegjël në treg. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të veçanta të fermerëve, posaçërisht atyre që janë në krye të ekonomive të tyre familjare.

Subvencione shtesë nga qeveria mund të krijojnë ambient të favorshëm për fermerët kosovar. Themelimi i Bankës Bujqësore mund t'iu ofrojë bujqve qasje në kredi aq të nevojshme afatgjate; ajo po ashtu do të duhej të ofronte kamata më të arsyeshme dhe periudha pozitive. Ekspertët nga BE-ja do të mund të bashkoheshin me autoritetet komunale, ekspertët vendor dhe bujqit për të bërë hulumtime të tregut që do t'iu ndihmonin bujqve të identifikonin tregjet e reja për produktet e tyre. Hulumtimi i tregut mund të ndihmojë në identifikimin e anës më të fortë tregtare të Gjakovës.

Pavarësisht pozitës së izoluar, Gjakova ka potencial për **tregti të ardhshme me jashtë**. Megjithatë, qyteti i Gjakovës është anashkaluar nga rrugët e reja që lidhin qytetet tjera (p.sh. Prizren-Tiranë dhe Ferizaj-Shkup). Komuna duhet të avokojë për politika qendrore që do të ringjallin rrugët historike të tregtisë, duke filluar me Shqipërinë. Marrëveshjet tregtare për uljen ose eliminimin e tarifave doganore të shoqëruara me subvencione bujqësore mund të japin bizneseve bujqësore qasje në tregjet e huaja.

Edhe pse mbetet të prodhojë rezultate të prekshme, hapja e Zyrës për Investime në Zurich nga Komuna e Gjakovës është iniciativë positive e cila synon të joshë investime direkte të huaja dhe nga diaspora. Shpërndarja e informatave për mundësi të investimeve në Gjakovë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ambasadave të Kosovës mund të jetë një mënyrë tjetër për **joshjen e investimeve të huaja direkte**. Shoqatat e Vendlindjes janë

treguar efektive në Meksikë, ku donacionet e diasporës për ‘vendet e tyre të lindjes’ janë shoqëruar nga autoritetet komunale dhe qendrore me projekte infrastrukturore dhe zhvillimore. Kjo mund të funksionojë në Kosovë, siç tregojnë edhe projektet e ngjashme infrastrukturore me investime të përbashkëta të diasporës dhe qeverisë në rajonin fqinj të Hasit (p.sh. shkollat, librat dhe rrugët).

Këtu, tradita e emigrimit nga Gjakova mund të shihet si pjesë e zgjidhjes, në vend se të jetë pjesë e problemit. Përveç investimeve potenciale nga diaspora, shumë gjakovarë që udhetojnë për në Prishtinë në kërkim të shkollimit, mundësive të punës, dhe një jetëse më të mirë, gjithashtu mund të dërgojnë edhe remitenca për të mbështetur familjet e tyre në Gjakovë. Për më tepër, Gjakovarët historikisht kanë përdorur pozitën e tyre në kryeqytet (dhe më gjerë) për të **ndikuar zhvillimin e politikave dhe nxitjen e investimeve** në regjionin e tyre. Gjakovarët mund t’i ripërtrijnë këto përpjekje edhe tani.

Në rrugën drejt zhvillimit njerëzor, autoritetet komunale duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të **siguruar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje**. Të rinjtë, gratë, romët, ashkalijtë dhe egjiptasit mbesin jashtëzakonisht të pambrojtur. Rritja e pjesëmarrjes së tyre në qeverinë komunale, përfshirë këtu në planifikim dhe buxhetim, është kyçe për identifikimin e zgjidhjeve për problemet e tyre të përditshme. Vendimmarrësit e zgjedhur dhe të emëruar duhet të dalin nga Gjakova dhe të takohen me persona të pambrojtur, në vend se të presin që ata të vijnë në zyret dhe tryezat e tyre.

Lidhur me këtë, zyrtarët e Njesisë për të Drejtat e Njeriut momentalisht kanë shumë funksione. Komuna duhet të caktojë një **buxhet të mjaftueshëm për rekrutimin e stafit të aftë dhe adekuat**. Donatorët ndërkombëtarë mund të ndihmojnë duke ofruar trajnime në vend të punës për kuadrot në mënyrë që ata të mund ta kryejnë punën e tyre në mënyrë efektive dhe efikase. **Strategji të qarta për ndikime konkrete** duhet të zëvendësojnë strategjitë e mjegullta drejt përmbushjes së qëllimeve kombëtare. Këto strategji duhet të përkrahen me buxhet vjetor permanent e jo me buxhet të alokuar në mënyrë ad-hoc.

Në mënyrë që të rinjtë të bëhen forcë shtytëse drejt zhvillimit, Komuna dhe donatorët mund të synojnë të sigurojnë **përkrahje financiare për Këshillet e Veprimt Rinor, qendrën rinore dhe Planin**, në të cilin të rinjtë kanë identifikuar nevojat kyçe. Qartëzimi i indikatorëve në Plan mund ta bëjë këtë të fundit edhe më efektiv. Pastaj, QRP-ja mund të lidh nevojat e tregut të punës me prioritetet e arsimit dhe mundësitë e punës praktike për të rinjtë.

Kryetari i Gjakovës duhet të **emërojë më tepër femra** si udhëheqëse të drejtorateve në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Plani i Zyres për Barazi Gjinore duhet të lidhet drejtpërdrejt me strategjitë kombëtare dhe të përfshij edhe aspektin e monitorimit. Anëtarët e parlamentit dhe ZBGJ-të duhet të vizitojnë dhe ndërveprojnë me femrat më rregullisht, meqenëse këto të fundit i **përfaqësojnë interesat e elektoratit të tyre** në Komunë. Femrat duhet të konsultohen në procesin e hartimit të programeve të partive politike, në planet e punës të departamenteve dhe në hartimin e buxheteve të departamenteve. Më gjerësisht, PVPE-ja duhet të mendojë se si politikat mund të kenë ndikim të ndryshëm tek femrat dhe meshkujt.

Një numër i madh veprimesh mund të ndërmerret për ti vënë femrat në një rrugë më direkte drejt zhvillimit ekonomik dhe njerëzor. Rishikimi i Skemës për Asistencë Sociale, siç parashihet në PVPE, duhet t'i marrë parasysh nevojat e veçanta të femrave që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare, duke ofruar përkrahje të shtuar siç janë librat dhe transporti falas në shkollë për fëmijët e tyre. Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duhet të caktoj një linjë buxhetore specifike për femrat që udhëheqin ekonomitë e tyre familjare dhe që punojnë në bujqësi. Për ta siguruar qasjen e gruas në pronë dhe kredi, strategjia për fuqizimin ekonomik të gruas duhet të trajtojë çështjet e trashëgimisë dhe mund të hartohen politika sipas të cilave kadastrat do të subvenciononte 50 përqind të kostos për regjistrimin e pronës për femrat që janë në krye të ekonomive të tyre familjare. Vetëdijësimi publik për të drejtat pronësore të gruas, ofrimi i këshillave ligjore, lehtësimi i procedurave për regjistrimin e pronës dhe tarifat e zvogëluara, mund ta rrisin qasjen e femrave në të drejtat e tyre pronësore. Kjo njëkohësisht do të mundësonte qasje në tokë dhe në kredi, dhe si rezultat kjo do të ndikonte në zhvillimin e bizneseve të tyre. QRP-ja poashtu mund të identifikoj mundësi që femrat ti zhvillojnë më tutje kapacitetet e tyre, përfshirë këtu edhe femrat mbi moshën 40-vjeçare, dhe/ose t'iu ndihmoj atyre të identifikojnë fushat ku mund të gjejnë punë me

aftësitë e tyre. Përkrahja e femrave që të gjenerojnë të adhurave vetanake do të mund ta ulte numrin e ekonomive familjare që varen nga asistenca sociale, duke kursyer kështu fonde të shtetit në planin afatgjatë.

Për tu siguruar që romët, ashkalijtë dhe egjiptasit nuk do të anashkalohej gjatë zhvillimit të Kosovës, vijimi i mësimëve mund të sigurohet duke e rritur vetëdijën e këtyre komuniteteve për vlerën e arsimit dhe duke aprovuar ligje që kërkojnë vijimin e mësimëve. Drejt sigurimit të pjesëmarrjes më të madhe, komuna duhet të inkurajojë përfshirjen e numrit më të madh të kuadrove rome, ashkali dhe egjiptase, në përputhje me PVPE-në. Departamenti komunal për arsim poashtu duhet të inkurajojë, nëpërmjet politikave të rekrutimit, angazhimin e numrit më të madh të kuadrove rome, ashkali dhe egjiptase. Plani i veprimit për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit duhet të finalizohet nëpërmjet një procesi më përfaqësues duke i përfshirë personat më të pambrojtur të këtij ‘komuniteti’ deri tani të homogjenizuar. Pastaj duhen siguruar fonde për zbatimin e planit. Përveç kësaj, projektet infrastrukturore duhet të shoqërohen me programe për integrim social. Në këtë drejtim nevojitet një qasje gjithpërfshirëse që e merr parasysh komunitetin shumicë: të transformohen normat shoqërore në mesin e qytetarëve të komunitetit shumicë drejt përfshirjes më të qëndrueshme të komuniteteve pakicë.

PËR IKS-in

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është *think-tank* i pavarur dhe jofitimprurës i cili përqendrohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe politika relevante me synim që të nxis debate për çështjet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë që debatet publike të bazuara në dëshmi janë thelbi i vendimmarrjes demokratike.

Që nga vera e vitit 2004, IKS ka zgjeruar stafin dhe sot përfshin tetë analistë dhe hulumtues me orar të plotë, dhe rrjet në rritje e sipër të hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve. IKS përkrahët në punën e saj nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga analistë dhe praktikantë Kosovarë dhe ndërkombëtarë.

Që nga zanafilla e saj, puna IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, planifikimit urban, korrupsionit në rindërtimin e pasluftës, mbrojtjen e ambientit, arsimit, problemit të imazhit të Kosovës si dhe strukturat qeverisëse ngatërruese të tanishme. IKS është poashtu pjesë e rrjetit të *think-tanks* në mbarë Evropën Juglindore të inspiruar nga ESI.

Të gjitha raportet tona mund ti gjeni në faqen tone të internetit: www.iksweb.org

Iniciativa Kosovare për Stabilitet — IKS

Telefoni: + 381 38 222 321

E-mail: info@iksweb.org

www.iksweb.org

Adresa:

Rr. Garibaldi H11/6, Prishtinë, Kosovë

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

33:005.8(496.51-2)(047)

En Route to the EU: Area-Based Development
Opportunities / [Kosovar Stability Initiative]. – Prishtina:
IKS, 2011. – 59 f. ; 21 cm. – (Policy Paper)

ISBN 978-9951-600-01-9

ISBN 978-9951-600-01-9



E shtypur në letër të recikluar me ngjyrë të recikluar